

Shoqata
Mikrofinansca
Shqiptare



Albanian
Microfinance
Association

RAPORTI VJETOR 2022

MIKROFINANCA SHQIPTARE



TABELA E PERMBAJTJES

1. MESAZH NGA PRESIDENTI
2. VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI EKONOMINE DHE ZHVILLIME TE SEKTORIT JOBANKAR GJATE VITIT 2022
3. SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE TREGUESIT FINANCIARE E OPERACIONALE
4. VEPRIMTARIA E ANETAREVE TE SHOQATES MIKROFINANCA SHQIPTARE
5. PERMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TE SHOQATES GJATE VITIT 2022
6. FINANCAT DIXHITALE
7. KERKIME DHE PUBLIKIME
8. LOBIMI DHE ADVOKIMI
9. RRRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TE ANETAREVE DHE BASHKEPUNIMI MES TYRE
10. PREZENCA NE MEDIA DHE RAPORTI ME PUBLIKUN

MESAZH NGA PRESIDENTI



MIKROFINANCA SI ZGJIDHJA AFATGJATE PER ULJEN E VARFERISE DHE LEVIZJEN E EKONOMISE

Të nderuar lexues,



Është bërë traditë tashmë, për mua, të inicioj raportin vjetor të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare me një fjalë përshëndetëse.

Edhe këtë vit kam nderin të ndaj me ju Raportin Vjetor të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, një raport i cili përmbledh ecurinë, progresin dhe sfidat e sektorit të Mikrofinancës në vend përgjatë vitit 2022. Këtë vit nuk do të jetë vetëm një fjalë përshëndetëse por edhe falenderuese. Pasi sigurisht asgjë në këto fjalë nuk do të kishte kuptim pa punën e madhe që është bërë gjatë vitit 2022 nga të 9 anëtarët e Shoqatës që përfaqësojnë mbi 90% të aktivitetit të këtij sektori në Shqipëri.

Viti 2022, ishte viti ku ripërtërimi i ekonomive pas efekteve të pandemisë arriti majat, por i cili nga ana tjetër na surprizoi me një ngadalësim në rritjen ekonomike në gjysmën e dytë të tij duke sjellë si pasojë një rritje në nivelet e inflacionit të pa jetuar prej dekadash tashmë!

Duket sikur në vitet e fundit, secili vit do të na tregojë se sa e brishtë është balanca ekonomike e vendit tonë, dhe se sa e rëndësishme është prezenca e kompanive të sektorit mikrofinanciar në këtë treg për të ndihmuar mbajtjen e balancave apo për të inicuar lëvizje të reja ekonomike, në dukje me efekt të vogël, por aq të rëndësishme për të krijuar baza të shëndosha për zhvillimin ekonomik në të ardhmen.

Prej më shumë se çerek shekulli në tregun shqiptar shumë prej kritikëve të kësaj industrie shprehen se cikli tashmë është mbyllur për këtë treg dhe se u duhet lënë vendi aktorëve të tjerë! Pas 25 viteve, ashtu si edhe gjatë vitit 2022, secili nga aktorët e tregut të mikrofinancave treguan se vetëm nëpërmjet këtyre institucioneve mund të arrihet një fleksibilitet i lartë, një adaptim si asnjë nga tregjet e tjera financiare në Shqipëri dhe akses në financim më i zgjeruar ndërkohë që të gjithë aktorët e tregjeve të tjera financiare aplikuan politika shtrënguese.

E them këtë me plot bindje, pasi janë shifrat të cilat tregojnë se edhe në një vit tjetër ku e gjithë ekonomia u ngadalësua, sektori mikrofinanciar ka treguar rritje në të gjithë indikatorët e tij!

Në total, të 9 anëtarët e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare kanë arritur:

1. Rritje të prezencës të degëve fizike me 10%
2. Rritje të stafit total me 13%
3. Rritje të portofolit aktiv në fund të 2022 me 14%
4. Rritje të numrit aktiv të klientëve në fund të 2022 me 11%
5. Rritje të volumit të disbursuar me 14%
6. Rritje të kredive ndaj bizneseve agro me 30%
7. Rritje të numrit të klienteve të gjinisë femërore me 50%
8. Rritje të numrit të kredive të disbursuara në zonat rurale me 153%

Të gjitha këto rezultate nuk janë thjesht numra por përkthehen në hapa gjigandë për të ardhmen e ekonomisë vendase. Të gjithë këto numra tregojnë për

1. Akses financiar më të madh si për bizneset ashtu dhe për individët
2. Edukim financiar për më shumë gra dhe vajza
3. Rritje e mirëqënies së komuniteteve ku operojnë këto biznese
4. Krijimi i më shumë vende pune
5. Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm për vendin

Gjatë vitit 2022 kjo rritje nuk do të ishte e mundur, nëse këto institucione nuk do të kishin një fokus të veçantë tek rritja e kapaciteteve të stafit të tyre nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme motivuese. Një investim i madh dhe dinjitoz i cili po i jep frytet e saj shpejt dhe të zgjata në kohë.

Gjithmonë e më shumë është punuar nga të gjithë anëtarët për të rritur strukturat mbështetëse të kredithënies, kontrolleve dhe përputhshmërisë të cilat rrisin garancinë e qëndrueshmërisë dhe performancës së institucioneve. Gjithashtu partneriteti me Qendrën për Mikrofinancën ka bërë të mundur edhe më tej ndarjen e eksperiencave më të mira të cilat e bëjnë këtë qendër një partner kyç për mbarëvajtjen e punës tonë.

Faleminderit të gjithë anëtarëve për punën dhe rezultatet e shkëlqyera! Faleminderit të gjithë punonjësve që na ndihmuan të arrijmë këto rezultate! Faleminderit të gjithë partnerëve strategjik të kësaj industrie që na ndihmojnë të përmirësojmë standartet tona çdo vit e më shumë!

Arlinda Muja
Presidentë-Shoqata Mikrofinanca Shqiptare



2 VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI EKONOMINE DHE ZHVILLIME TE SEKTORIT JOBANKAR GJATE VITIT 2022

2.1 Disa Aspekte Kryesore Ekonomike në Nivel Ndërkombëtar e Kombëtar

Viti që kaloi, ishte një tjetër vit me ngjarje të jashtëzakonshme politike-ushtarake dhe ekonomike në rang ndërkombëtar e rajonal, të cilat pa dyshim patën ndikime madhore edhe në vendin tonë. Tregjet globale sapo kishin filluar të rikuperoheshin si rezultat i lehtësimit të kufizimeve shkaktuar nga Pandemia Botërore dhe pasojat e rënda të Covid 19, kur konflikti i luftës Rusi-Ukrainë, i cili shpërtheu në Shkurt të vitit 2022, e vuri ekonominë botërore përballë një shoku masiv në një situatë të paprecedentë. Ekonomia e Eurozonës dhe e rajoneve të tjera në Europë, ishin veçanërisht të ndjeshme ndaj këtyre efekteve, kjo lidhur edhe me faktin që në Europë nuk kishte patur ndonjë konflikt ushtarak të përmasave të tilla që pas Luftës së Dytë Botërore.

Ndikimet e menjëhershme të luftës u ndjenë në sektorin e energjisë dhe atë të drithërave duke krijuar një krizë gjithëpërfshirëse. Dinamikat e zhvillimit të këtij konflikti çuan në sanksione të fuqishme ndaj Rusisë dhe ashpërsim të marrëdhënieve politike midis shteteve të përfshira, duke prekur në një shkallë të konsiderueshme ekonominë botërore, e për rrjedhojë edhe atë shqiptare në tërë dimensionet e saj. Këto riformatuan dhe përcaktuan gjëndjen e mëtejshme duke i dhënë një drejtim të paparashikueshëm gjithë stabilitetit dhe aktivitetit ekonomik e social në pjesën tjetër të vitit. Si rezultat i rritjes së skajshme të çmimeve e po ashtu mungesës së lëndëve të para, u tronditën gjithë sektorët e ekonomisë dhe industrisë, u ndjenë luhajtje dhe spekulime serioze në tregjet financiare, kurset e këmbimit të monedhave, import-eksportet, bllokime e ngërçe në furnizim e shpërndarje, pezullim e ngadalësim në ecurinë e bizneseve, e rrjedhimisht pasiguri për të ardhmen dhe ngritjen e koston së jetesës për gjithë shoqërinë.

Ne fjalën e tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Sejko në konferencën për shtyp gjatë TR2 të vitit

2022, theksoi se: “Ekonomia botërore dhe Shqipëria vijojnë të jenë subjekt i goditjeve të shkaktuara të konfliktit Rusi-Ukrainë, i cili rriti çmimet e energjisë, ushqimeve, mallrave dhe shërbimeve. Konflikti në Ukrainë dhe sanksionet e vëna ndaj Rusisë, pra të dyja këto ngjarje dëmtuan ndjeshëm zinxhirët e furnizimit global për shumicën e produkteve jetike si energjia, nafta dhe ushqimet, mallra dhe shërbime të tjera” Presionet inflacioniste pësuan një rritje të ndjeshme në nivel ndërkombëtar, të mbartura gjithashtu edhe në nivelin kombëtar duke shënuar hovin e parë nga 4.4% në 5.7% në mes të vitit, e më tej në vazhdim, duke arritur maksimumin në Tetor 2022 prej 8.3% - niveli më i lartë gjatë 24 viteve të fundit. INSTAT raportoi se “familjet shqiptare në vitin 2021 çuan 41% të shpenzimeve mujore për ushqime, ndërsa gjatë vitit 2022, inflacioni i grupit të ushqimeve u rrit me 12% gati dyfishi i rritjes së përgjithshme të çmimeve”

Sektori Bankar, ai Jobankar dhe i Mikrofinancës në Shqipëri u gjendën para së njëjtës situatë me sfida e pengesa të paparashikuara, por në nota pozitive, duhet thënë se pavarësisht rritjes së dukshme nga vala e parë e krizës, çmimet e energjisë dhe të shportës së të mirave materiale, pati disi një stabilizim relativ në kushtet kur ekonomia u rrit me një ritëm midis 3%-4%. Duke mbajtur parasysh edhe faktorët të tjerë stimulues nga ana e qeverisë, autoriteteve financiare botërore dhe Bankës së Shqipërisë, kërkesa dhe oferta në tregjet financiare mbeti e qëndrueshme dhe premtoi zgjatje në kohë, me nivel likuiditeti të shëndetshëm dhe të mirë-kapitalizuar, ndërkohë që norma bazë e interesit në Shqipëri mbeti e pandryshuar, në nivelin 2.75%. Gjatë kësaj periudhe, kushtet e financimit si për individët, edhe për qeverinë, mbetën favorizuese.


2.2 Veprimtaria e Sektorit Jobankar dhe të Mikrofinancës

Sektori jobankar dhe i mikrofinancës, i cili përbën rreth 10% të aktiveve financiare dhe 11% të PBB në vend, vazhdoi të mbetet një pjesë e rëndësishme dhe vitale e ekonomisë, duke luajtur një rol të pazëvendësueshëm në fuqizimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit dhe mirëqenies së familjeve në vendin tonë. Nisur nga fakti që ekonomia shqiptare mbështetet tek mikrobizneset, të cilat zënë rreth 90% të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, mikrofinanca shqiptare vazhdoi të funksionojë si një hallkë mjaft efektive për të arritur qëllimet financiare të subjekteve, duke mbështetur ato për të hyrë dhe ndërvepruar në tregjet financiare, e thënë ndryshe – në përfshirjen e tyre financiare. Ky sektor siguron që këto burime të jenë të arritshme, duke zbutur dhe lehtësuar kushtet e financimit, kursimit dhe depozitimit, dhe në të njëjtën kohë duke reduktuar problemet me informalitetin, te drejtat ligjore dhe pronësive, si edhe burimin dhe nivelin e të ardhurave. Krahas financimit të bizneseve në tregëti, shërbime e ndërtim, dhe

individëve të vetë-punësuar, start-upeve, fermerëve dhe bizneseve në agrikulturë, ky sektor vazhdoi të kontribuojë në rritjen e mirëqenies sociale, fuqizimin e grave, shtimin dhe krijimin e vendeve të reja të punës, si edhe rritjen e edukimit financiar në nivel kombëtar.

Sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit sektori jobankar shqiptar përbëhej nga institucionet financiare jobanka (IFJB), shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe unionet e tyre, shoqëritë e sigurimit, fondet e investimit dhe ato të pensionit – konkretisht nga 38 IFJB, 16 SHKK dhe 1 union, 12 shoqëri sigurimi, 11 fonde investimi dhe 6 fonde pensioni. Peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar e zë aktiviteti i institucioneve financiare jobanka të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, i ndjekur nga fondet e investimit që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Grafik 1- Struktura e Sektorit Jobankar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Duke konsideruar disa nga sfidat më të spikatura për vitin 2022 të cilat i përmendëm më lart, sigurisht që sektori jobankar dhe i mikrofinancës hasi vështirësi konkrete, direkte dhe indirekte. Në planin parësor mund të themi se rritja e çmimeve të energjisë dhe naftës rriti në mënyrë të drejtpërdrejtë kostot operacionale dhe vështirësoi procesin kryesor, atë të kredithënies duke rritur normat e interesave në një ambient me nivele inflacioni të larta. Paralelisht


me këtë, një sfidë po aq e rëndësishme ishte edhe pasiguria për burimet e financimit nga subjektet rezidente dhe jo-rezidente, si nga ana e kapitalizimit ashtu edhe për rritjen e kostos së fondeve. Nderkohë që kërkesa nga ana e bizneseve mbeti pothuaj e njëjtë, dhe deri diku shënoi rritje, kërkesa për kredi e individëve u tkurr perkohësisht nga pasiguria për të ardhmen dhe rritja e ndjeshme e kostos së jetesës.

2.3. Ecuria e Sektorit Jobankar dhe Indikatorët Kryesorë Financiarë dhe Operacionalë

Duke iu referuar disa të dhënave marrë nga publikimet e Bankës së Shqipërisë¹ bëhet e ditur se në përgjithësi, pavarësisht ngadalësimit të aktivitetit gjatë tremujorit të parë, për sektorin jobankar shënohet rritje në të gjitha aspektet financiare dhe operacionale. Sipas këtyre të dhënave, sektori jobankar dhe mikrofinanciar vazhdon të tregojë për një pozicion të ekuilibruar midis aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Ndër **Aktivet** kryesore janë huatë si aktivitet kryesor me 43%, ndjekur nga pagesat dhe transfertat me 21%, si dhe letrat me vlerë të borxhit. **Detyrimet** përfaqësohen nga kapitali dhe aksionet në fondet e investimit, hua të marra nga bankat rezidente, jo-rezidente dhe borxhi i varur.

Grafik 2- Vlera e Aktiveve dhe Detyrimeve të Sektorit Jobankar




Kredia për Individët zë 54% të totalit të kredisë, ndërsa 46% i takon bizneseve. Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe aktivitete të tjera shërbimi

janë sektorët më të financuar nga IFJB-të (19% e totalit të stokut për bizneset), ndjekur nga ndërtimi me 13%.

¹ Burimi- Raporti i Stabilitetit i Bankës së Shqipërisë. për 6-mujorin e dytë

Grafik 3 -Pesha e Kredisë për Individë dhe Biznese



Rreth 70% e kapitalit të paguar të institucioneve jobanka është financuar nga kapital vendas. Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet i lartë, ndërkohë që cilësia e portofolit të kredisë shënoi rënie në terma tremujorë me RKP nga 13% në 14%, megjithatë u përmirësua në krahasim me fundin e vitit 2021.

Shoqëritë e kursim-kreditit shënuan zgjerim të aktivitetit të tyre kredites me anëtarët dhe regjistruan një fitim neto pozitiv, duke treguar për një përmirësim të lehtë të cilësisë së portofolit nga një vit më parë. Raporti i huave me probleme ra në 5.4% krahasuar me 6.2% të një viti më parë. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën kryesore e zënë investimet në kredi (69%) dhe investimet në banka në formën e depozitave me afat (21%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit është sektori i bujqësisë (36%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (13%).


Në referencë të të dhënave për vitin 2022, vetëm për sektorin jobankar (për 38 institucionet jobankare apo mikrofinanciare) mund të themi se:

Sistemi financiar jobankar numëronte gjithsej 38 subjekte financiare jobanka (IFJB) në fund të vitit 2022 me një shtesë prej 3 subjektësh në raport me vitin 2021.


Totali i aktiveve të IFJB-ve, arriti nivelin 81.12 miliardë lekë, duke u rritur gjatë këtij viti me 4.83 miliardë lekë ose 6%. Kjo rritje është gjeneruar kryesisht nga subjektet: Paysera (2.1 miliardë), NOA (2 miliardë), lutecredit Albania (1.5 miliardë), Kredo Finance (1 miliardë), etj. Ndërsa "Fondi Besa" rezultoi me reduktim të totalit të aktiveve për rreth 3 miliardë lekë. Aktivitetet e IFJB arrijnë në **4.14%** të totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Sipas Raportit të Mbikëqyrjes për vitin 2022, Banka e Shqipërisë raporton se "Në strukturën e aktiveve të IFJB-ve peshën kryesore e mban portofoli i kredisë me 52%. Pjesa tjetër është e shpërndarë në aktive likuide (22%), të tjera të arkëtueshme (10%), tituj me të ardhura të ndryshueshme (7%) dhe mjete të tjera (përfshirë mjetet e qëndrueshme) (8.5%). Burimet kryesore për IFJB-të janë huamarrjet (48% e pasivit) dhe kapitali i tyre (38%). Huamarrja nëpërmjet emetimit të titujve zë 0.4%. Lidhur me huamarrjet, balanca anon lehtë nga jorezidentët me 56.5%"

Grafik 4: IFJB-të Shpërndarja e Aktiveve, Dhjetor 2022



Grafik 5: IFJB-të Shpërndarja e Burimeve të Financimit, Dhjetor 2022



Duhet përmendur që aktiviteti me rritjen më të lartë gjatë vitit 2022 e ka patur mikrokredia (me rreth 2.6 miliardë lekë) Në fund të vitit 2022, portofoli i

kredisë bruto për IFJB-të arrin në **47.4 miliardë lekë**, duke njohur një rritje prej 5.3 miliardë (ose 12.5%) krahasuar me vitin paraardhës

Tabela 1: Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e IFJB-ve

Treguesi (mld lekë)	Dhejtör 2019	Dhjetör 2020	Dhjetör 2021	Dhjetör 2022
Totali i Portofolit të Kredisë për IFJB-neto	33.0	33.5	37.4	42.0
Totali i Portofolit të Kredisë për IFJB-bruto	35.5	36.6	42.1	47.9

Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së IFJB-ve përbëhet nga subjektet e kredihënies dhe mikrokredisë (77%). Në vend të dytë vjen portofoli i subjekteve të qirasë financiare (22%) dhe portofoli i subjekteve faktoring (1%). Portofoli i kredisë së IFJB-ve arrin në 6.24% të totalit të kredisë së sistemit bankar, duke regjistruar një rritje prej 0.34 p.p. krahasuar me peirudhën e mëparshme

Sektorët me nivelin më të lartë të financimit në vitin 2022 janë "Tregtia, riparimi i automjeteve" me 18.73%, "Aktivitete të tjera shërbimi" me 18.70% dhe "Ndërtimi" me 12.16%. Portofoli i

IFJB-ve mbetet i orientuar drejt financimeve në monedhën vendase (66%) dhe me afat të mesëm maturimi (72%).

Rritja e totalit të kredive me probleme shfaqet më e lartë tek subjektet e kredihënies dhe mikrokredisë

Në fund të vitit 2022, treguesi i kredive me probleme për subjektet financiare është zvogëluar me 0.4 pikë përqindje. Ky rezultat është ndikuar nga rritja e portofolit të financimeve me rreth 12.53% (ose 5.3 miliardë lekë) ndërsa rritja e kredive me probleme ka qenë rreth 9%.

Rezultati Financiar i IFJB-ve për 2022

Gjatë vitit 2022, IFJB-të kanë gjeneruar një rezultat pozitiv prej **3.33 miliardë lekë**, shifër e cila reflekton një rënie me 0.33 miliardë lekë (9%) me vitin paraardhës. Subjektet me kontribut më të lartë në fitimin e realizuar nga IFJB-të janë: "Tranzit", "Kredo Finance", "NOA", "Unioni Financiar Tiranë", "Iute Credit".

Rezultati neto i IFJB-ve përbën rreth 13.3% të rezultatit të sistemit bankar. Kthimi mesatar nga aktivet (ROA) për IFJB-të arrin në 4.11% (kundrejt 4.8% në vitin 2021), ndërsa kthimi mesatar nga kapitali (ROE) arrin në 10.47% (kundrejt 15.39% në 2021)

Cilësia e Portofolit për IFJB-të në fund të vitit 2022

Raporti i huave me probleme (NPL) ra në 4.7%, nga 5.2% në fund të vitit 2021. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën më të madhe e zënë investimet në kredi (72%) dhe investimet

në banka në formën e depozitave me afat (18%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit është sektori i bujqësisë (30%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (14%).

Tabela 2: Ecuria e treguesit të cilësië së portofolit të kredisë

Treguesi (në %)	Dhejtör 2019	Dhjetör 2020	Dhjetör 2021	Dhjetör 2022
Kredi me Probleme - Teprica e Kredisë Bruto	9.69	11.20	13.60	13.20
Kredi me Probleme - Teprica e Kredisë Neto	4.14	4.38	3.96	3.54

Burimi: Banka e Shqipërisë

Të gjitha segmentet e tjera të sistemit financiar, përveç fondeve të investimit, kanë regjistruar zgjerim të aktivitetit. Pjesa jobankare e sistemit financiar vijon të mbetet e mirëkapitalizuar dhe me një cilësi të mirë të portofolit të kredisë për institucionet kredituese, që kanë raportuar rënie të raportit të kredive me probleme krahasuar me fundin e vitit të kaluar

Raportimet e Bankës së Shqipërisë, gjithashtu citojnë se ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar (IFJB) mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe rezulton në rritje krahasuar me dhjetorin 2021.

3

SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE,
PRIORITETET STRATEGJIKE DHE TREGUESIT
FINANCIARE E OPERACIONALE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (SHIM), përbëhet nga nëntë anëtarë; Agro & Social Fund, Crimson Finance Fund Albania, FedInvest SHKK, Fondi BESA, luteCredit Albania, Kredo Finance, NOA, dhe Uni-Fin SHKK. Shoqata ka një strukturë mikse që vjen si kombinim i Institucioneve Financiare Jo-Banka (IFJB) dhe Shoqëri Kursim Krediti (SHKK). Në veprimtarinë e saj për rreth dy dekada, ajo ka vazhduar të realizojë më së miri vizionin dhe qëllimin e saj në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, dhe veçanërisht në përfshirjen financiare të sipërmarrësve të vegjël dhe NVM-ve, individëve të vetëpunësuar, fermerëve, e në të njëjtën kohë për të nxitur krijimin e vendeve të punës nëpërmjet forcimit të sektorit të mikrofinancave dhe institucioneve që veprojnë në të.

Edhe gjatë vitit që kaloi, falë përpjekjeve bashkëpunuese dhe kolektive, u shënuan rezultate të kënaqshme dhe shoqata arriti të përmbushë objektivat e saj kryesore:

- Të përfaqësojë sipas nevojës anëtarët e saj në takime, konferenca, seminare, sesione trajnimi, konsultime legjislative dhe evente biznesi në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.
- Të mbështesë konsolidimin institucional dhe teknik të anëtarëve të saj, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe identifikuar trendet financiare dhe ekonomike
- Të nxisë edukimin dhe njohuritë financiare, aksesin në financim, etikë të përgjegjshme biznesi dhe sociale, si edhe sektorin e mikrofinancës në tërësi.

Përsa i përket sektorëve të ekonomisë, pjesa më e madhe e veprimtarisë së anëtarëve është angazhuar në tregti, ndërtim, shërbime dhe agrikulturë, kredi konsumatore për familje e individë, duke reflektuar kështu natyrën tipike të tyre ndaj biznesit mikro e

të mesëm, dhe segmentit konsumator. Në zonën Tiranë-Durrës dhe ato të tjera urbane në Shqipëri ka një përqendrim më të lartë të ndërmarrjeve private përkundrejt pjesës rurale e cila shfaq kërkesë për kredi nga fermerët, në agrikulturë, artizanat dhe individët e vetë-punësuar të cilët hasin vështirësitë më të mëdha për t'u përshirë në sektorin financiar.

Gjatë vitit 2022, si gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, IFJB-të operuan jo vetëm në një ambient ekonomik me norma inflacioni të larta pasuar nga një rritje e ndjeshme e çmimeve - fenomene të cilat janë më së shumti të importuara - por edhe në një situatë kombëtare ku u vu re tendenca emigrimi përtej shifrave normale, me fluks largimi në vazhdim të një pjesë të popullatës, veçanërisht në brezat e reja. Ndonëse të rrethuar nga sfida dhe vështirësitë që përmendëm, IFJB-të nuk e ndalën procesin e kredidhënies dhe gjetën zgjedhje e zgjidhje origjinale për vazhdimësinë e biznesit. Të gjithë anëtarët funksionuan me kapacitet të plotë duke konsoliduar edhe më tej asetet, duke zgjeruar e forcuar aspekte të ndryshme të biznesit si financimet dhe aksesin në produkte e shërbime financiare, rritjen e numrit të stafit dhe të klientelës, dixhitalizimit të mëtejshëm të platformave për instrumentet financiare, fushatave sensibilizuese të marketingut dhe burimeve njerëzore.

Anëtarët e shoqatës ndjekin një politikë të përgjegjshme sociale që synon të përfshijë dhe integrojë individë të përjashtuar financiarisht dhe në zona gjeografike të pafavorizuara për të ngushtuar boshllëqet gjinore në sipërmarrje, e gjithashtu ofrimin e këtyre mundësive në mënyrë të qëndrueshme. Është e qartë tanimë se sektori do të jetë i shëndetshëm vetëm nëse të gjithë anëtarët ndjekin praktika të shëndetshme dhe në fokus kanë të mirën e përgjithshme.

3.1 Përmbledhje për veprimtarinë kryesore në perputhje
me strategjinë e shoqatës dhe anëtarëve të saj

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare nëpërmjet realizimit të objektivave ka arritur të rrisë edhe më tej vizibilitetin institucional dhe impaktin pozitiv e konkret në shoqërinë shqiptare. Roli i saj në përfaqësim, prezantim, promovim, ndërmjetësim, edukim, përhapje dhe mbledhje njohurish, bëri të mundur që anëtarët e saj të flasin me një zë të unifikuar për një sërë çështjesh mjaft të rëndësishme lidhur me praktikën e biznesit, procesin e kredidhënies, normat e interesit, kuadrin ligjor dhe mbikëqyrës që rregullon veprimtarinë e mikrofinancës në Shqipëri, e gjithashtu duke sjellë në pah instrumente të reja financiare midis anëtarëve të saj dhe publikut të gjerë.

Disa nga pikat më të forta dhe ndërmarrjet frytdhënëse janë shkëmbimi i eksperiencës midis anëtarëve, shoqatave dhe organizatave homologe si në rang vendi ashtu dhe në plan ndërkombëtar, ndërveprimi e ndërlidhja nëpërmjet platformave e takimeve virtuale, seminareve e uebinareve, konferencave dhe tryezave të përbashkëta.

Viti 2022 u karakterizua nga një veprimtari aktive dhe e gjerë e shoqatës dhe anëtarëve të saj me angazhime dhe pjesëmarrje të rëndësishme nga ana e të gjitha palëve.

Mund të themi me një siguri të plotë se mikrofinanca shqiptare tashmë ka hyrë në një fazë të re zhvillimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm. Krahas punës në aspektin tradicional të biznesit, gjatë vitit 2022, një fokus të veçantë pati edhe arritja e disa objektivave shtesë për të arritur nivelin e veprimtarisë së periudhës para pandemisë. Një pjesë e mirë e përpjekjeve dhe fondeve u drejtuan gjithashtu edhe në përmirësimin e shtimit e kapaciteteve, sistemeve të brendshme të informacionit dhe teknologjisë, proceseve dhe procedurave të transformimit dixhital dhe shërbimeve online. U krijuan platforma të reja, disa prej tyre "end-to-end" për produkte të caktuara, si edhe u shtuan lidhjet me ndërmjetës dhe ente fintech të ndryshëm për pagesa e transfertat elektronike.

Në të njëjtën mënyrë, iu kushtua kujdes dhe rëndësi aspektit të marrëdhënieve me klientët dhe trajnimet e vazhdueshme të punonjësve me njohuri të përditësuar për produktet financiare, së bashku me kuptimin, manaxhimin dhe zbutjen e risqeve në këtë industri. Në kuadrin operacional dhe atë të perputhshmërisë, pati trajnime frekvente lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit.

Në misionin e saj social, në bashkëpunim të ngushtë edhe me homologë e organizata të tjera ndërkombëtare, shoqata vazhdoi të punojë për edukimin e klientëve drejt rritjes së njohurive financiare e dixhitale duke qenë pararendëse e ndryshimeve dhe duke ofruar financim të përgjegjshëm dhe shërbim tërësor. Një vend të veçantë zënë veprimtaritë me bazë edukimin financiar, në kuadër të **Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar** dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë të tregut, për të siguruar një gjithëpërfshirje të popullatës dhe shtresave të saj në ofertën me shërbime dhe produkte financiare. Po ashtu, në plan frontal ishte edhe puna për prezantim e zgjerim të njohurive për **"Financat e Gjelbra"** duke përcjellë e shkëmbyer eksperiencën, sesione trajnimi mbështetur në kuadrin rregullator të vendosur nga Parlamenti Europian dhe ai i Shqipërisë, materiale shpjeguese e bashkëkohore shoqëruar me udhëzime për këtë aspekt relativisht të ri të financimit e kredidhënies në sektorin e mikrofinancës.

Nuk duhet lënë pa përmendur që në vazhdim e përpjekjeve për fuqizimin dhe forcimin e rolit të gruas në shoqëri, sektori i mikrofinancës bëri një dallim progresiv duke krijuar produkte specifike me rezultate të dukshme me produkte të dizenuara posaçërisht për gratë si në familje dhe në biznes.

Kontributi i grupeve të punës të ngritura enkas për këto qëllime, lidhur me identifikimin, diskutimin dhe përmirësimin e këtyre elementëve ka qenë shumë i çmuar në riformatimin e disa nga proceseve për të lehtësuar aksesin në financa të klientëve dhe thellimin e njohurive teorike e praktike nga vetë anëtarët.

Disa nga veprimtaritë e kryera i listojmë më poshtë:

1. Mbledhje e grupeve të punës të krijuara për elementët kryesorë strategjikë
2. Pjesëmarrje aktive në konferencën e 24-vjetorit të MFC në Turqi
3. Aderime në shoqata të tjera dhe emërime prestigjioze; Drejtimi i Keshillit Mbikëqyrës të Microfinance Centre (MFC) nga Sekretarja e Përgjithshme e SHIM
4. Aktivitete për "Ditën Europiane të Mikrofinancës"
5. Konferencë virtuale për Ballkanin dhe Europën Lindore, Microfinance Centre (MFC) – "Social Finance Vibe 2022"
6. Sondazhe dhe pyetësorë me temë: "Impakti Social i Mikrofinancës"
7. Konferenca "Tirana Fintech Days ", si konferencë e parë për teknologjinë financiare dhe transformimet dixhitale.

8. Fushata dhe forume me temë: "Huamarrje e Zgjuar 2022".
9. Konferenca kombëtare "Tirana Fintech Hive 2022" për start-upet dhe të ardhmen e fintech-ut në Shqipëri.
10. Konferenca "All-Web"


Në kuadër të arritjes së objektivave të shoqatës, por edhe për të forcuar e konsoliduar imazhin e industrisë në vend në funksion të politikëbërjes, institucioneve mbështetëse dhe tregut të synuar, mund të themi se këto evente e grupe pune kanë mundur të japin rezultate të kënaqshme. Një theks të fortë kanë patur edhe marrëdhëniet me entet qeveritare, rregullatorët, autoritete financiare dhe lobimit në drejtim të mbështetjes së institucioneve të mikrofinancës me vendimarrje cilësore nga ana e tyre, për të bërë sa më të lehtë dhe transparent procesin për shtresat më në nevojë.

3.2. Ecuria e Aktiveve dhe Portofoli i Kredisë së Anëtarëve të Shoqatës

Anëtarët e Shoqatës në mënyrë të integruar kanë një total bilanci mbi **51.0 Mld Lek**, përafërsisht dhe një portofol kredie prej rreth **39.6 Mld Lek**, duke

reflektuar një rritje në vëllim prej 8.5% dhe 13.1% përkatësisht.

Grafik 6 – Vëllimi total i Aktiveve në fund të vitit 2022 (shifrat në Mil lek)




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Portofoli i Kredisë

Në vëllimin total aktiv të Kredisë, prej **39.6Mil** Mld ose 30%, e pasuar nga kredia për fermerë dhe agro-biznes me 5.8 Mld ose 15%, e në fund kredi të tjera me 0.9Mld lekë ose 2%. Peshën më të madhe e zë kredia për biznes me 20.2Mld lekë ose 53%, kredia për individë me 11.3

Grafik 7 – Teprica e Kredisë në vëllim, shpërndarja sipas kategorive apo segmenteve në fund të vitit 2022



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kredia e Re për vitin 2022, në vëllim dhe numër


Në kredinë e re të dhënë gjatë vitit 2022 vëllimi total i disbursuar ishte në vlerën **34.2Mld lekë**, shifër e cila reflekton një shtesë prej **5.2Mld ose 18.0% më e lartë se viti 2021**.

Të parat renditen përkatësisht kredite për individë me 18.5Mld, të cilat zënë peshën më të madhe prej 62.5% së vëllimit të disbursuar, shtesë prej 3.3Mld ose 21.4% më lart se viti i mëparshëm. Më pas vijjnë kredite për biznese të cilat me vëllimin

prej 11.5Mld u zgjeruan me 631.7 Mln ose 5.8%. Vazhdojnë kredite për bujqësinë dhe blegtorinë me 3.5Mld, duke reflektuar shtesë vjetore prej 900Mln lekë ose 33.9%, dhe në fund janë kredite të tjera me 740.9Mln disbursim, apo zgjerim prej 425.6Mln ose 134.9% më shumë.

Vlen të përmendet fakti që mbi 80% e financimit të akorduar për bujqësinë gjatë vitit 2022 pati si burim mikrofinancën.

Grafik 8– Vëllimi i Kredisë së Disbursuar gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 sipas kategorive (shifrat në Lekë)




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Numri total i kredive të akorduara në numër për vitin 2022 ishte **297, 813** një numër i cili përfaqëson **37,876 ose 14.6% rritje krahasuar me një vit më parë.**

Nga këto, pothuaj peshën kryesore e zë kredia për individë me një shifër prej 274,999 duke shënuar shtesë prej 37,480 ose 15.8% më lart se viti 2021. Kredia e re e vendosur në dispozicion të biznesit u ngushtua këtë vit; shifra prej 15,717 është 267 ose 1.6% më pak se periudha vjetore e mëparshme.


Kreditë për fermerë dhe agrobiznese, u zgjeruan me 1000 ose 18.5%, ndërsa numri i kredive të tjera pësoi një rënie në vlerë absolute me 337 ose 32.4% krahasuar me një vit më parë.

Grafik 9 – Kreditë e dhëna në numër sipas kategorisë së klientit, viti 2022



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Grafik 10 - Vëllimi i Disbursuar për Njësi Kreditore në lekë në terma mesatare gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 "ticket size"




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Përsa i takon cilësisë së portofolit të kredisë, sipas shifrave të raportuara nga anëtarët, gjatë vitit 2022 u reflektua një ulje e portofoleve në vonesë prej më shumë se 30 ditësh, indikator që qëndroi në vlerën e 8.3% - përmirësim i dukshëm me 11% për fundin e vitit 2021, kundrejt shifrës prej 13.23% për fundin e vitit 2020 (shifrat u referohen vetëm anëtarëve të

Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare). Institucionet anëtare kanë marrë masat përkatëse duke rritur nivelin e provigjionimit për kreditë me probleme, kryesisht të financuara nga kapitali i tyre dhe kontributet e aksionerëve në formën e injektimeve të reja.

Grafik 11 – Përqindja e kredive me mbi 30 ditë vonesë kundrejt totalit të kredive (total vëllim i portofolit me probleme ndaj tepricës së kredisë, vëllimi bruto “gross”)




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Struktura e financimit të institucioneve anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare ndryshoi ndjeshëm gjatë vitit 2022, në favor të kapitalizimit më të lartë kundrejt financimeve dhe donacioneve, si edhe depozitave të SHKK-ve. Një fenomen tjetër që u vu re, si rezultat i krizës së shkaktuar nga lufta

në Ukrainë dhe ngritja e çmimeve, është edhe ndryshimi i normave të interesave për disa nga burimet e financimeve, - nga një traditë me norma interesi fikse tashmë në blerje fondesh (për një pjesë të kreditorëve) me kosto variabël në varësi të indekseve ndërkombëtare.

Grafik 12 dhe 13– Struktura e përbërjes gjinore në numrin e klientëve aktive, dhe sipas zonave Urbane dhe Rurale



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Sektori i mikrofinancës paraqitet i mirëkapitalizuar dhe në gjëndje të përballojë edhe humbjet e përlogaritura sipas skenarëve të mundshëm optimiste dhe pesimiste, veçanërisht kundrejt manaxhimit të rrezikut të kredisë dhe përfaqseve prudente ndaj një sërë faktorësh si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këtë e dëshmojnë edhe indikatorët financiarë në vijimësi, ku shumica e institucioneve janë në përputhje me standartet rregullatore të aplikuara në normalitet.

Kemi një rritje të lehtë në nivelin e të kapitalit të aksionerëve për vitin 2021, ndërkohë që rritja në totalin e detyrimeve është realizuar në masën 35.6% për të mbështetur veprimtarinë kredituese. Gjithashtu rritja e aktiveve në masën 11.8 % dëshmon ecurinë pozitive të portofolit të kredive si edhe investimet e kryera nga institucionet anëtare për të rritur standartin e cilësisë së shërbimit të klientëve dhe mbështetur dixhitalizimin.

4

VEPRIMTARIA E ANETAREVE TE
SHOQATES MIKROFINANCA SHQIPTARE
GJATE VITIT 2022

4.1. Agro & Social Fund shpk

Viti 2022 pritej të ishte një vit rikuperimi dhe "shërim" nga pandemia që po shuhej. Megjithatë, fillimi i vitit nisi me probleme të shtuara. Pushtimi rus i Ukrainës dhe efektet zinxhir qe solli ai në rritjen e çmimit të hidrokarbureve, në rritjen e kostove të prodhimit, dhe në përgjithësi, në nivele inflacioni të pahasura në dekada, patën ndikim të rëndësishëm në jetën ekonomike të familjeve, bizneseve të vogla e të mesme në Shqipëri. Pavarësisht vështirësive të hasuara, në përgjithësi viti 2022 rezultoi të ishte një vit pozitiv për Agro & Social Fund. Rezultati financiar ishte i kënaqshëm, arritëm të firmosim bashkëpunime me partnerë të rinj kombëtar e ndërkombëtar, zgjeruam bashkëpunimin me partner aktualë. Në mënyrë të përmbledhur:

- Administruam një portofol prej rreth 1.037 miliardë lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve iu është shërbyer rreth 30,973 klientëve, duke disbursuar rreth 6.3 mld Lekë.
- Në mbyllje të vitit 2022, 60% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 47% klientë gra.
- Një staf prej 84 punonjësish ishte në shërbim të 3,305 klientësh

- Gjatë fillimit të vitit, pasi kaluam me sukses të gjitha proceset e parashikuara, nënshkruam marrëveshjen me EIF, për shumën prej 1 mln Euro, dhe po në atë periudhë u kalua dhe transhi i parë i cili u vendos në dispozicion të klientëve tanë, nëpërmjet një produkti të dizenuar enkas për këto fonde.
- Gjatë vitit 2022 arritëm 2 marrëveshje, me Easy Pay dhe Union net Western Union, duke iu dhënë mundësinë klientëve tanë për kryerjen e pagesave në pikat më të afërta që gjenden pranë tyre.
- Ka vijuar ngritja e fondeve me partnerin KIVA (vlerësuar për shkak të fee-ve të ulta të fondeve sipas kategorive dhe gjatë vitit 2022 duke e vlerësuar bashkëpunimin mes nesh si të sukseshëm, Kiva vendosi të rrisë limitin e fondeve deri në 1.5 mln euro.

Për shkak të punës tonë disavjeçare me fushatën "Borrow Wisely", gjatë Konferencës së MFC, mbajtur në Stamboll, ASF iu akordua një çmim për pjesëmarrje dhe angazhim në promovimin e standarteve globale të mbrojtjes së konsumatorit.

Synimet dhe Strategjia për Vitin 2023

Bazuar në projeksionet e ngritura në Biznes Planin e periudhës afatshkurtër për vitin 2023, ASF synon:

ASF deri në fund të vitit 2023 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.175 mld lekë dhe të ketë disbursuar kredi për rreth 2,940 klientë, me një shumë të disbursuar prej 918 mln lekë;

- ASF do përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur NPL-të në nivelin e parashikuar jo më shumë 4 % si dhe do synojë shtimin apo përmirësimin e instrumenteve për kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën. Ka filluar tashmë puna për ndërtimin e RAF, e cila pritet të vihet në funksion gjatë vitit 2023;
- ASF deri në fund të vitit 2023 synon të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin me shërbime financiare në zona të tjera rurale e gjysmë urbane,

nëpërmjet konsolidimit të zyrave ekzistuese e shtimit të një dege të re;

- ASF synon të përmirësojë ofertën e produkteve të saj nëpërmjet përmirësimit të produkteve në tërësi, në koherencë me zhvillimet dhe duke iu përshtatur nevojave të klientelës.
- Në funksion të realizimit të synimeve mbi performancën dhe rritjen, ASF planifikon rritje të përqëndruar në degë të burimeve njerëzore me rreth 13%.
- ASF përgjatë 2023, por e shtrirë për të mundur përmbylljen, në periudhën afatmesme 2023-2025, do synojë të realizojë investime të qënësishme për garantimin e metejshëm të sigurisë e integritetit të të dhënave, rritjen e cilësisë së punës me sistemin e informacionit; përmirësimin e infrastrukturës së pagesave të kësteve nga klientët etj.



CRIMSON FINANCE FUND

4.2. CRIMSON FINANCE ALBANIA

Crimson Finance Fund Albania (CFFA) është një institucion financiar me një mision social për të rritur aksesin në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, start-upet dhe aktivitetet që gjenerojnë vende të reja pune. CFFA kërkon të mbështesë këto grupe ndërmarrjesh me financime dhe këshillim financiar duke i ndihmuar të dalin nga « rrethi vicioz i të qendruarit të vegjël ». Me një gamë të gjerë produktesh si kredi me këste, qira financiare (leasing), linjë kredie dhe faktoring, CFFA synon të mbulojë nevojat e këtyre ndërmarrjeve në investime, kapital qarkullues, apo shtim dhe përmirësim të aseteve fikse.

Crimson Finance Fund Albania financon sektorin e manufakturës tre herë më shumë se mesatarja e tregut financiar në proporcion me portofolin e saj, si edhe i dedikon rreth 25% të disbursimeve të saj start-upeve, duke u bërë kështu një promotor dhe një derë e hapur për këto të fundit, të cilët përfitojnë përveç financimit edhe një konsulencë të personalizuar falas në lidhje me planin e tyre të biznesit dhe projeksionet financiare.

Viti 2022 ka qënë një vit tepër i suksesshëm për CFFA përse i përket performancës së tij, pavarësisht sfidave në treg në lidhje me rritjen e normave të interesit. Përgjatë këtij viti CFFA arriti të rrisë portofolin e tij me 36% duke e çuar atë në 554 Million Lekë. Kjo rritje u shoqërua gjithashtu edhe me një rritje të nivelit të disbursimeve me 30% duke e çuar këtë nivel në 353 Million Lekë. CFFA arriti

gjithashtu të ulë nivelin e kredive me probleme në 4.7% në mbyllje të vitit 2022, si edhe të rrisë me 24% nivelin e EBIT krahasuar me një vit më parë.

Viti 2022 shënoi gjithashtu një gure-themeli në konsolidimin e mëtejshëm të strukturës së kapitalit të CFFA, me hyrjen e ortakut tonë të ri, fondit Helenos, i pari fond European i fokusuar në financën gjithëpërfshirëse, dhe i mbështetur nga Bashkimi European dhe Banka Europiane e Investimeve.

Përgjatë vitit 2022 CFFA u fokusua gjithashtu në zgjerimin e numrit të stafit në secilin nga departamentet e tij, në modernizimin e mëtejshëm të sistemeve operative të brendshme dhe të atyre që ndërveprojnë me klientët dhe partnerët tanë, si edhe në zgjerimin e fushatave të marketingut indirekt përmes rrjetit të partnerëve dhe pjesëmarrjes në forume sektoriale.

CFFA synon të vazhdojë me vendosmëri përmbylljen e misionit të ortakeve të saj përgjatë vitit 2023, duke u bërë një aktor i rëndësishëm në tregun financiar vendas me pozicionimin midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare përse i përket vlerës së financimit dhe kushteve të ofruara. CFFA do të vazhdojë të përqendrojë aktivitetin e saj në financimin e aseteve, aktivitetëve prodhuese dhe start-upeve duke bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare financiare që mbështesin financën sociale dhe synojnë rritjen e impaktit të hua-ve tona me qëllim ngushtimin e hendekut të aksesit në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla.



4.3. FED Invest SHKK

Viti 2022 shënoi 30-vjetorin e fillësive të veprimtarisë së FED invest, si kooperativa më e madhe financiare në Shqipëri. Duke u organizuar si një institucion në pronësi e në shërbim të anëtarëve, në këto tri dekada aktivitet, kemi ditur të ofrojmë zgjidhje kreative dhe të ndërtojmë partneritete strategjike, duke i kushtuar vëmendje ruajtjes së balancës delikate: qëndrueshmëri financiare dhe impakt social. Në çdo etapë zhvillimi kemi pasur vizionin dhe gjetur forca për të realizuar ndryshime të rëndësishme institucionale, në funksion të nevojave të anëtarësive, duke dëshmuar njëkohësisht imunitet të admirueshëm, fleksibilitet dhe reagim të duhur ndaj krizave të ndryshme.

Viti 2022, si një vit jubile për FED invest ka qenë i veçantë edhe në shumë aspekte të arritjeve institucionale:

- rritje solide e anëtarësisë në afër 87 mijë anëtarë, që shërbehen nga 300 punonjës dhe 64 degë në të gjithë Shqipërinë;
- rritje e portofolit të kredisë me afërsisht 16% mbi bazë vjetore ose në nivelin e 5.6 miliardë Lekëve;
- zgjerim i shërbimit të pagesave utilitare për anëtarët në shumë rajone të vendit;
- përmirësim i cilësisë së portofolit të kredisë dhe konsolidim i rezultatit financiar.

Gjatë vitit 2022, FED invest ka qenë prezent për anëtarët dhe publikun me një seri aktivitetesh promionale dhe të marketingut fizik dhe atij digjital: është publikuar libri mbi historikun dhe aktivitetin e FED invest në vite, bashkë me një broshurë përmbledhëse, si dhe është promovuar filmi dokumentar që përshkruan udhëtimin historik 30-vjeçar të institucionit.

FED invest në fund të 2022 rendit në treguesit e tij, gjithashtu:

- Totali i aktiveve 7.6 miliardë lekë me një rritje prej 7.9% për vitin;
- Depozitat e anëtarëve prej 5.0 miliardë lekësh me një normë rritjeje prej 6.7% për vitin
- Mjaftueshmëria e Kapitalit – 22.6%

Përfshirja e grave:

- 37% e anëtarëve
- 62% e të punësuarve
- 70% e drejtuesve të lartë

Shërbime jo financiare – Qendra ABA dhe platforma e saj abaonline.al:

- Mbi 15 mijë të regjistruar që marrin një sërë shërbimesh jo-financiare të lidhura me bujqësinë dhe blegtorinë, informacion dhe këshillim për teknologjitë e prodhimit dhe standartet e produkteve, kalendarin e fermës, çmimet e tregut, si dhe promovojnë produktet e tyre online dhe krijojnë partnerite të biznesit.
- 40-të aktivitete, trajnime online dhe demonstrime praktike në fermë;

Në vitin 2023, FED invest do të vazhdojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke ofruar produkte konkurruese të kredive dhe depozitave dhe do ta zgjerojë më tej gamën e shërbimeve financiare dhe jo-financiare. Do të prezantohen shërbime të reja të pagesave utilitare dhe të digjitalizuara, do të zgjerohet rrjeti i partnereve të biznesit dhe do të rriten shitjet online.



4.4. Fondi BESA

Arritjet gjatë vitit 2022

Edhe gjatë vitit 2022, që ishte një vit i vështirë, një vit që shënoi paqëndrueshmëri të vazhdueshme ekonomike, ku konflikti gjeopolitik dhe efektet e vazhdueshme të pandemisë globale ishin evidente, rezultatet e Fondit Besa demonstuan forcën tonë të strategjisë afatgjatë, duke vazhduar shërbimet në mbështetje të biznesit të vogël dhe të mesëm që ishte dhe mbetet sektori më i prekur nga kriza Covid 19.

Pavarësisht nga mjedisi sfidues operativ, Fondi Besa tregoi elasticitet dhe performoi në përputhje me objektivat e tij afatmesme për plotësimin e kërkesave për financim të tregut të tij. Pasiguria ekonomike që ka përcaktuar ritmin e zhvillimit këto tre vitet e fundit, vetëm sa e ka intensifikuar fokusin tonë në ofrimin e vlerave për klientët tanë, duke hedhur në treg shërbime dhe produkte të reja për t'i ndihmuar ata të menaxhojnë bizneset e tyre në këtë periudhë sfiduese, duke ua bërë më të lehtë të bëjnë biznes me ne dhe për punonjësit tanë për t'u shërbyer klientëve tanë. Viti 2022 ka treguar se mënyra se si ne bëjmë biznes, kujt tregu i shërbejmë, ku kemi shtrirë aktivitetin tonë janë të gjitha reflektime të planit strategjik për të cilin ekipi ynë ka punuar me zell për të zbatuar gjatë vitit të fundit. Mbështetja e konsiderueshme e biznesit, e klientelës sonë, dhe vendimet strategjike që kemi marrë e kanë pozicionuar Fondin Besa jashtëzakonisht mirë për të ofruar rritje të qëndrueshme, afatgjatë dhe kthime të forta të aksionerëve për vitet në vijim.

Gjatë vitit 2022, zhvillimi i aktivitetit të Fondit BESA sh.a ka njohur arritje dhe realizime, të cilat kanë kërkuar përpjekje dhe orientime të qarta menaxheriale në të gjithë nivelet e vendimmarrjes. E përfunduar vitin 2022 me rezultatet e mëposhtme:

- Portofoli i kredisë rezulton në shumën 14,106,919,111 lekë
- Numri i kredive aktive rezulton në 27,199
- Disbursimet në numër rezultojnë në 14,367 kredi
- Disbursimet në vlerë rezultojnë në 7,365,512,931 lekë
- Është rritur numri i produkteve të kredisë.
- Është punuar për të ruajtur një nivel relativisht të kënaqshëm risku.
- Është punuar për mbështetjen e stafit në të gjitha nivelet në këtë vit të vështirë.
- Janë realizuar kontakte efektive dhe nënshkruar marrëveshje me donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve.

Sigurisht, krenohemi që kemi dhënë kontributin tonë modest në rritjen e ekonomisë së vendit, duke mbështetur bizneset e vogla dhe të mesme dhe duke krijuar vende pune.

Strategjia jonë ka për qëllim të mirëmbajë një ekip punonjësish që janë të orientuar në rezultate, të aftë të ndjekin ritmin e institucionit dhe të identifikohen me misionin e tij, suksesin tek stafi ynë ekzistues dhe tek tërheqja e punonjësve të rinj të talentuar dhe tek përmirësimi i komunikimit me të gjithë nivelet e stafit, me qëllim forcimin e mëtejshëm të punës në ekip dhe rritjen e efikasitetit të punonjësve. Gjatë vitit 2022, janë organizuar rreth 64 aktivitete trajnimi ku janë trajtuar 30 tematika të ndryshme. Nga këto trajnime kanë përfituar 1,080 pjesëmarrës, çka do të thotë se një anëtar stafi ka përfituar më shumë se një trajnim. Në fokus është kultivimi i marrëdhënieve korrekte dhe afatgjata me klientët, përmirësimi i përvojës me ta mbetet një objektivi i rëndësishëm dhe kjo është arritur nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të duhura financiare, krijimit të marrëdhënieve të besimit,

komunikimit të hapur dhe kujdesit të shkëlqyer ndaj klientit për të garantuar kënaqësinë e klientit në nivelin më të lartë.

Gjatë vitit 2022, Fondi Besa i ka kushtuar kujdes menaxhimit të riskut, të tregut, likuiditetit dhe rreziqeve operacionale, duke e identifikuar, analizuar, dhe matur atë me kujdes gjatë gjithë aktivitetit të institucionit, të ndërgjegjshëm për nivelin e riskut ndaj të cilit jemi të ekspozuar duke marrë masat për ta mbajtur në nivel të menaxhueshëm dhe të kontrollueshëm. Duhet theksuar se, edhe gjatë vitit 2022, cilësia e kredisë u arrit të mbahej në nivelet e parashikuara.


Gjatë vitit 2022, Fondi BESA vazhdon të jetë pronar 100% i aksioneve të Institucionit Mikrofinanciar "Social and Agro Fund".

Kredo.al

4.5. KREDO FINANCE

Viti 2022 nisi si një vit premtues, dhe në fakt pavarësisht se fati e vendosi ekonominë globale përsëri në një sprovë, Kredo Finance e mbajti premtimin e saj. Siç shihet qartë edhe nga grafiku, ky vit solli një trend më të njohur të dinamikës ekonomike. Fillimi i vitit ishte i qendrueshëm dhe në muajt Mars-Maj, kompania përjeto rritjen e pritur në këtë periudhë. Rritja më e madhe përkon me produktin e Kredisë me Këste, duke na treguar edhe një herë rëndësinë që ka për individin një ndarje e shpenzimeve në kohë. Kërkesa për kredi mbetet gjithmonë me ritme të larta, dhe mban një balancë

deri në muajin Tetor. Muaji Dhjetor dëshmon një rritje të konsiderueshme si në numër aplikimesh ashtu dhe në kredi të disbursuara. Janë disa faktorë që sollën këtë stabilitet dhe rritje në vitin 2022. Kredo Finance gjatë vitit 2022 ka qëndruar besnik me strategjinë e saj për të ofruar produkte me ulje tek konsumatorët besnik, por gjithashtu këtë vit për të ndihmuar të gjithë klientët e rinj të gjendur përsëri para një krize financiare të ndikuar nga rritja e çmimeve, ka sjellë pothuajse gjatë gjithë vitit kredinë me disa këste me 0% Interes.



Viti 2022 ishte një vit forcimi! Marka e Kredo Finance arriti që të njihej nga 71% e të intervistuarve! Kjo na bën krenarë dhe të sigurtë se dhe viti që na pret do të jete një vit suksesi absolut!

TRANSFORMIMI DIXHITAL ESHTË NJË NGA PIKAT ME TE FORTA TE KOMPANISE.

Duke pasur statusin Kompani Fintech, është përgjegjësi dhe prioriteti ynë të sjellim inovacion në tregun financiar Shqipëtar. Gjatë vitit 2022 ne

përmirësuam edhe më tej procesin e aplikimit dhe disbursimit online duke e thjeshtuar dhe shpejtuar edhe më tej premtimin prej 15 minutash.

ZGJERIM FIZIK PERTEJ PREMTIMIT FILLESTAR

Për ti ardhur sa më parë çdo individ ne kemi zgjeruar prezencën fizike me partneritetë strategjike me palë të treta, të cilat bëjnë të mundur tashmë që të gjithë ata që kanë nevojë për financim të drejtohen në të gjitha vendet ku ata mund të shohin një logo të Kredo.al!

TRAJNIME TE VAZHDUESHME PER RRIJTEN NDËRPERSONALE DHE PROFESIONALE TË STAFIT

Gjatë vitit 2022 Kredo Finance rriti kapacitetet e punonjësve nëpërmjet trajnimeve, përmirësimeve individuale, si profesionale ashtu dhe ndërpersonale. Një qasje e tillë na ka bërë një nga kompanitë më të preferuara në tregun e punës dhe ka pasur impakt direkt në rezultatet dhe suksesin e kompanisë. Gjatë vitit 2022 janë dhënë gjithsej 69 trajnime të cilat në total kane patur 2176

pjesmarrës, me një mesatare prej 10 trajnimesh për punonjës.

Nuk mund të qubesh Fintech nëse nuk sjell produkte të reja në treg! Gjatë vitit 2022 Kredo Finance solli një tjetër mundësi fantastike për të gjitha bizneset të cilat janë të regjistruara me statusin e Personit Fizik. Kjo do të thotë se të gjithë klientët të cilët kanë një NIPT të regjistruar si Person Fizik dhe e kanë këtë biznes aktiv mund të marrin një kredi pranë të gjitha degëve të kredo Finance.

71%

NJIHET NË VITIN 2022
NGA POPULLATA

100%

ONLINE,
PROCESI APLIKIMIT

10

TRAJNIME PER
PUNONJËS

PLANET E SE ARDHMES

PLANET TONA JANE AFATGJATA DHE AMBICIOZE DHE PER VITIN 2023 KREDO FINANCE PLANIFIKON

1. TE KRIJOJE HAPESIRA TE REJA FINANCIMI
2. TE ZGJEROJE DHE ME TEJ RRJETIN E SAJ TE SHERBIMEVE
3. TE ZGJEROJE NDIKIMIN E SAJ NE RRIJTEN E NIVELIT TE EDUKIMIT FINANCIAR
4. TE RRISE KAPACITETIN PERFORMUES TE STAFIT TE SAJ NEPERMJET NJE PROGRAMI INTENSIV DHE SPECIFIK TRAJNIMESH PROFESIONALE DHE PERSONALE



4.6. luteCredit Albania

luteCredit Albania

"luteCredit Albania" Sh.a është themeluar si një shoqëri aksionare më **4 Gusht 2014** dhe ka objekt kryesor të veprimtarisë së shoqërisë aktivitetet në fushën e kredidhënies, shoqëri e cila filloi veprimtarinë e saj duke ofruar kredi konsumatore në Prill 2015.

Vizioni: Njerëzit do të përdorin shërbime financiare të shpejta dhe do të transferojnë para menjëherë. Ne jemi pjesë e kësaj të ardhmeje. Përvoja e jashtëzakonshme e klientëve është arsyeja përse njerëzit do të kthehen sërish.

Misioni i luteCredit është të krijojë një përvojë të jashtëzakonshme në financat personale, duke tejkaluar pritshmëritë e klientëve. luteCredit Albania i garanton të gjithë klientët me produktet e kredisë, të cilat janë kredi konsumatore pa garanci, me maturitet nga 1 deri në 48 muaj. Shoqëria është pjesë e Grupit luteCredit Europe AS me qendër në Estoni, e cila është e listuar në bursën e Frankfurtit, dhe që është aksioneri 100% i kapitalit të luteCredit Albania.

Edhe viti 2022, ashtu sikurse viti para-ardhës, ishte një vit pozitiv në drejtim të rritjes, ku përqindja mesatare vjetore (APR) e kredive të disbursuara është ulur përsëri në 54.3% nga 59% që ishte gjatë vitit 2021, ndërsa tendenca për vitin 2023 është të ulet deri në 50%.

Investimi në Dixhitalizim është shumë i rëndësishëm për të ardhmen në integrimin pa probleme të

luteCredit Albania me e-commerce në Shqipëri. Gjatë vitit 2022 i gjithë grupi luteCredit u fokusua në zhvillimet e reja teknologjike, të cilat u finalizuan brenda vitit 2022 me implementimin dhe prezantimin e sistemit të ri qendror (NC - New Core) në filialet më të mëdha të grupit, ku përfshihet edhe luteCredit Albania.

Totali i aktiveve të shoqërisë në 2022 u rrit me 29% krahasuar me 2021, ndërsa fitimi neto kontabël pati një rënie gjatë 2022 për shkak të rritjes së shpenzimeve administrative dhe investimeve në teknologji, edhe niveli i të ardhurave totale u rrit me 7%. Viti 2022 u karakterizua nga një rritje e normave të interesit për fondet në të gjithë botën, si pasojë e rritjes së inflacionit dhe luftës në Ukrainë dhe kjo u reflektua edhe në një rritje të shpenzimeve të interesit për huamarrjet prej 5% gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin para-ardhës.

Portofoli i kredisë në fund të 2022, rezultoi me 29% rritje nga viti i kaluar. Cilësia e kredisë vazhdon të jetë shumë e mirë ku edhe në fund të 2022 ripagesat e kredive brenda harkut kohor të 30 ditëve me vonesë përbëjnë 90%.

Numri i total i klientëve u rrit me 7.3% ndërsa ai i klientëve aktiv të mirë rrit me 6.4% krahasuar me të dhënat e një viti të mëparshëm. Numri i punonjësve në fund të vitit 2022 u rrit me 7% krahasuar me vitin 2021. luteCredit Albania vijon investimet në zhvillimin dhe përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të punonjësve të saj duke krijuar një mjedis nxitës të zhvillimit përmes programeve të trajnimit, ku

gjatë vitit 2022 secili punonjës ka kryer mesatarisht 1-2 trajnime të ofruara nga trajnues të jashtëm.

Ne gjithashtu këshillojmë dhe mbështesim klientët tanë në shumë kanale të tjera komunikimi: telefon, email, Facebook, WhatsApp, Viber, biseda në internet ku ofrojmë përvojë të pandërprerë të klientit. Qendra jonë e kontaktit u është përgjigjur me sukses

1.1 milion kërkesave nga klientët në 2022 dhe ne iu përgjigjëm 80% të thirrjeve tona nën 20 sekonda. Vetë teknologjia e firmës elektronike të përdorur nga aplikacioni i tyre "Mylute" ka reduktuar maksimalisht printimin e letrave, rrjedhimisht dhe ndotjen e mjedisit.

PRITSHMERITE NE TE ARDHMEN - 2023

luteCredit Albania ka disa pritshmëri për vitin 2023 :

1. Zgjerimin e natyrës së produkteve dhe shërbimeve për klientët tanë
2. Investime të pandërprera në Financat Dixhitale,
3. Investime në rrjetin e ATM-ve në të gjithë Shqipërinë
4. Investime në procese teknologjike specifike si : identifikimi elektronik i klientëve dhe nënshkrimi elektronik i tyre përmes ofruesve të besuar të shërbimit
5. Rritja e vazhdueshme e treguesve kryesorë financiarë;



4.7. NOA

Gjatë 5 viteve të fundit, NOA ka njohur një konsolidim të qenësishëm të aktivitetit të saj kredidhënës, dhe viti 2022 nuk bëri përjashtim. Injektimi në ekonominë shqiptare vetëm gjatë vitit të shkuar të 46.58 milion eurove është shifra që e konfirmon më së miri këtë fakt. Nga kjo vlerë, 35.6 milion euro i janë dedikuar ekskluzivisht aktiviteteteve ekonomike e prodhuese të cilat kanë impaktuar mbi 13 mijë vënde pune drejtëpërsëdrejti. Ky është thelbi i misionit të NOA-s. Ky është pasioni që drejton punën e ekipeve tona, dhe që vijon të mbetet në themelin tonë : mbrojtja e ekonomisë familjare, sipërmarrëse e rurale.

Një mision që merr akoma më shumë rëndësi përballë krizës inflacioniste që goditi ekonominë kombëtare e atë rajonale. Rritja e çmimeve dhe rreziku i rënies së standarteve të jetesës për familjet shqiptare, bëri që NOA të angazhohej edhe më tej me financime të përshtatura për familjen duke injektuar 10.92 milion euro në mikrokredi vetëm për këtë segment. Një angazhim që konfirmohet dhe nga fakti që gjatë vitit 2022, janë 3,442 kredi të disbursuara ndaj klienteve gra, ku 30% e tyre janë gra në biznes e të vetëpunësuar në fshat apo qytet, dhe pjesa tjetër familjare.

Në paralel, një rregull i përvitshëm tanimë, NOA u angazhua gjatë vitit 2022 dhe në fushatën sensibilizuese "Kredimarrje e mënçur" organizuar nga Shoqata Europiane e mikrofinancës si një mënyrë për të luftuar mbi-kreditimin. Një angazhim, që merr dhe më shumë vlerë përballë krizës inflacioniste që po kalon ekonomia familjare, angazhim etik e i matur ndaj riskut, që bëri që niveli i PAR90 për vitin 2022 të mbyllej me 2.02%. Një tjetër provë kjo e një besimit reciprok që ekziston mes NOA-s dhe klientëve të saj çka mundëson thellimin e marrëdhënies financiare në kushte transparence e serioziteti maksimale.

Besnikë ndaj fokusit të dedikuar në drejtim të ekonomisë bujqësore, dhe gjatë vitit 2022 NOA u investua për të mbuluar me financimet e saj sa më gjerësisht nevojat e fermerëve shqiptare, kudo që ndodhen. Përpos faktit se 8.5 milion euro u dedikuan vetëm për financime agro-biznesesh, u organizuan 18 aktivitete, trajnime e pjesëmarrje në panairë me fokus bujqësinë, në nivel kombëtar e lokal. Shtu këtu edhe realizimi dhe shpërndarja falas e 38 agro-fishave këshillimore në drejtim të klientëve agro, si një kontribut i drejtëpërdrejtë në rritjen e impaktit të financimeve të NOA me qëllim prodhimin e një vlere të shtuar realisht me impakt. Të tilla rezultate u arritën me një investimin konstant në ndërtimin e një rrjeti njerëzor, teknologjik e operacional referencë për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri e në rajon. Gjatë vitit 2022 NOA përmbylli me sukses konsolidimin përfundimtar të shërbimit dixhital ndaj klientit, virtualizimin e të dhënave dhe përditësimin e sistemit informatik qëndror. Këto investime i mundësuan NOA-s që të rrisë në mënyrë të qenësishme sigurinë, cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimit ashtu si mbrojtjen e privacisë së klientëve të saj.

Ndërkohë që viti 2022 u përmbyll me një ndryshim të strukturës aksionere, angazhimi për vitin 2023 në terma të vizionit e misionit të kompanisë mbetet i pandryshuar. Slogani zyrtar i NOA për vitin 2023 i miratuar në përmbyllje të vitit të kaluar do të jetë ai i një **FinanceNjerëzore**, dëshmi e një investimi besnik ndaj zhvillimit socioekonomik të vendit tonë. Një dëshmi për një angazhim vlerash. Një objektiv afat-gjatë në shërbim të ndërtimit të një marrëdhënieje të qëndrueshme e të respektueshme me çdo bashkëpunëtor të kompanisë, me çdo përfitues të financimeve tona. Një #FinancëNjerëzore, sepse pas çdo shifre kreditimi, ka një histori njerëzore ndërtuar me këmbëngulje, mund e sakrificë. Viti 2022 ishte një vit plot sfida për ekonominë shqiptare. Por së bashku me klientët tanë, ia dolëm për një tjetër vit suksesi.



4.8. UniFin SHKK

Përshkrim i aktivitetit gjatë 2022, Zhvillimet kryesore, Prioritetet strategjike dhe Objektivat për vitin 2023

SHKK UniFin ka vazhduar të ofrojë shërbime të plota financiare për anëtarët e saj, me profesionalizëm dhe përkushtim ndaj çdo anëtari, në përputhje me misionin tonë.

Edhe ky vit i ndjeu pasojat rehabilituese të post-pandemisë si dhe situatës politike e cila solli inflacion të rritur për inerci të veprimeve makro. Pati rritje të çmimeve të të gjitha produkteve baze si rrjedhojë e rritjes së çmimit të karburantit duke rritur kostot e nivelit të jetesës dhe si rrjedhojë e përkthyer në një kërkesë të ulët të kredive për qëllime konsumatore. Në sistemin financiar në Shqipëri, bankë dhe mikrofinancë, pati rritje të interesave të produkteve depozite & kredi, si dhe rritje të kërkesave regullatore. Theksojmë këtu që gjatë këtij viti kryefjala ishte

sulmet kibernetike ndaj institucioneve financiare dhe institucioneve shtetërore nga ku pati rrjedhje të informacioneve konfidenciale të individëve dhe kompanive.

Ashtu si të gjitha institucionet financiare dhe shtetërore, edhe në UniFin u vu theksi në rritjen e sigurisë së informacionit nëpërmjet trajnimeve të shpeshta, urdhëresave e regulloreve të ndryshme dhe investimeve në teknologji.

Që prej krijimit të UniFin fokusi kryesor ka qenë shërbimi i përkushtuar i anëtarëve të saj nëpërmjet produkteve dhe transparencës së tyre si dhe mirëpërfomimi i këtij institucioni nëpërmjet treguesve financiarë.

• Indikatorët financiarë të UniFin për 2022

	Volumi		Volumi
Kapitali	192,916,709.02	Total Asete	1,285,009,497.52
Portofoli i Depozitave	1,054,149,114.18	Portofoli i Kredisë Bruto	1,013,609,756.15
Shuma e Kredive të Disbursuara	598,115,276.00	Nr. i Kredive të Disbursuara	1.315
Kredia Mesatare	569,123.95	Portofoli ne Risk (NPL)	4.14%

Vlerat e tabelës në lek.

Disa nga investimet dhe zhvillimet kryesore gjatë vitit 2022 ishin:

- U zhvillua dhe u implementua sistemi kompjuterik SQL
- U ndërmoren iniciativa marketing si pjesëmarrja në panairin Agro në Lushnjë, Prill 2022
- Investime në degët e UniFin, të nevojshme për të patur një rrjet të unifikuar në paraqitjen e tyre.
- Investime në sistemin kompjuterik dhe IT-së të rrjetit.

Zhvillime të tjera të suksesshme gjatë 2022 ishin dhe Raporti i Kontrollit nga Banka e Shqipërisë për periudhën 09/2019 – 09/2022 si dhe institucione të tjera si ASD dhe DPPP.

Objektivi kryesor edhe për këtë vit do të jetë:

• Synime dhe objektiva për vitin 2023

- Rritja në numër e anëtarësise në UniFin
- Shërbimi i personalizuar me transparencë ndaj anëtarëve
- Rritja e portofolit të kredive dhe mirëpërfomimi i këtij portofoli
- Rritja e portofolit të depozitave
- Zgjerimi i rrjetit me dege të reja në zona gjeografike tek të cilat nuk ka përfaqësim
- Rishikimi i performacës së degëve me fokus rialokim të burimeve njerëzore në degë që kanë përfitueshmëri më të lartë.
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit

5 PERMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TE SHOQATES GJATE VITIT 2022

5.1 Mbledhje të grupeve të punës me tematika kryesore të sektorit

5.1.1 Transformimi i Gjellbër dhe Mikrofinancat

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare zhvilloi seminarin online me temë: "Transformimi i Gjellbër dhe Mikrofinancat" 24 Mars 2022

Si pjesë e aktiviteteve të kryera nga ofruesit dhe produktet e shërbimeve mikrofinanciare në të gjithë Evropën, zbatimi i Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji e re për rajonin, duke kërcyer nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme. Në përputhje me këtë Shoqata Shqiptare e Mikrofinancës organizoi më 24 Mars 2022 një seminar online me temë **"Transformimi i Gjellbër dhe Mikrofinancat"** Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësues të lartë nga institucionet financiare ndërkombëtare, përfaqësues të komunitetit të biznesit, institucioneve financiare jobankare dhe aktivitetit mikrofinanciar, të cilët kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme për sektorin.

Takimin në hapje e përshëndeti Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës, Znj. Brunilda Isaj, e cila nënvizoi rëndësinë e hyrjes në financat e gjelbra në ditët e sotme. Kjo gjë sjell mundësi të reja dhe përfitime të mundshme, por nuk është pa sfida. Është një linjë e re biznesi për shumicën e institucioneve mikrofinanciare e cila kërkon ndryshime në procedurat e brendshme operative, produktet financiare dhe metodat e vlerësimit të kredisë. Në këtë pikë, shumë institucione mikrofinanciare që nuk janë të njohura me metodologjitë e financave të gjelbra e perceptojnë


atë si të rrezikshme dhe të vështirë për t'u futur. Si rezultat, shumë ndërmarrje mikro dhe të vogla (NMV) dhe individë që nuk kanë gjasa të financohen nga bankat kryesore, mbeten të nënfinancuara dhe të kufizuara për të arritur potencialin e tyre të plotë. Më pas, u diskutua mikrofinanca e gjelbër në kuadrin konceptual si edhe këndvështrimi i sektorit karshi tij, dhe më gjerë. Të ftuara si folëse në këtë panel ishin znj. Venera Hoxha, Oficere e Lartë e Investimeve pranë Finance in Motion – Green for Growth Fund, znj. Ana Deinzer, Drejtore e Zyrës në Shqipëri dhe Drejtuese Rajonale në Europën Juglindore e German Sparkassestiftung for International Cooperation, si edhe znj. Elma Zukic, Presidente e Shoqatës së Institucioneve të Mikrofinancës në Bosnjë-Hercegovinë. Të tre folëset përshkruan këndvështrimet e tyre në lidhje me rëndësinë e financës së gjelbër, si e shohin atë investitorët dhe çfarë projektsh kanë ndërmarrë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe strategjia sektoriale e adoptuar për ta zhvilluar si linjë biznesi.

Në panelin e dytë, konceptuar si një ndarje eksperiencësh nga ana e praktikuesve të mikrofinancës në nivel kombëtar e rajonal, të ftuar ishin Z. Senad Sinanovi, Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni Mikrofinanciar Partner, nga Bosnja-Hercegovina, znj. Alma Stafa, Drejtore e Marketingut

dhe Menaxhimit të Produkteve pranë Fondi BESA sh.a. si edhe z. Akil Kraja, Drejtor i Projekteve dhe Zhvillimit të Biznesit, NOA sh.a. Folësit përshkruan eksperiencën e tyre në dizenjimin e linjës korporative për të mbështetur axhendën e gjelbër dhe për të ofruar në treg produkte të cilat ndihmojnë ambientin, shfrytëzojnë burime alternative të energjisë duke inkurajuar inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në ekosistem, si edhe mbështesin klientët për të zbatuar

sisteme efçente dhe në ruajtje të mjedisit për të pasur një ndikim sa më të gjerë në standartet jetësore të shoqërisë.

Eventi u ndoq me interes nga një numër i madh pjesëmarrësish nga institucionet mikrofinanciare, institucionet financuese dhe investitorë, aktorë në treg që promovojnë axhendën e gjelbër dhe organizata që e mbështesin atë.



5.1.2 Mbledhje e Grupit të Punës Nr. 2 – Instrumente të financimit për startup-et inovative

Shoqata Shqiptare e Mikrofinancave zhvilloi një tryezë teknike me EU4Innovation me temë: "Instrumentet e Financimit për startup-et inovative" 23 Qershor, 2022

Tryeza rreth instrumenteve të financimit për startup-et inovative, e organizuar nga Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe EU4Innovation u mbajt më datë 23 Qershor 2022, në ambientet e Europehouse, me një grup të përzgjedhur pjesëmarrësish, përfaqësues të Institucioneve Mikrofinanciare në Shqipëri, startup-eve në faza të ndryshme të zhvillimit, organizatave në mbështetje të inovacionit (ISO), si dhe aktorëve të tjerë të ekosistemit.

Institucionet mikrofinanciare në Shqipëri po shqyrtojnë mundësinë e sigurimit të aksesit në financa për startup-et, të cilat do mund të aksesonin

një financim fillestar për të lançuar aktivitetin e tyre, dhe në planin afatgjatë do mund të kontribuonte në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit. Për këtë arsye, një tryezë teknike ku startup-et dhe aktorët e ekosistemit mundën të ndajnë eksperiencat dhe njohuritë e tyre rreth instrumenteve të financimit, dhe të shkëmbeheshin drejtpërdrejt me përfaqësuesit e AMA-s, dhe të diskutonin mbi mundësitë dhe skenarët e ardhshëm për ofrimin e mbështetjes, të përshtatur me nevojat specifike të startup-eve në segmente të ndryshme të zhvillimit, u konsiderua mjaft e dobishme.



5.1.3 Mbledhje e Grupit të Punës Nr. 3-Mbledhja e Investitorëve Potencialë

Shoqata Shqiptare e Mikrofinancave organizoi një tryezë të rrumbullakët me Investitorë të huaj me temë: "Zhvillimi i sektorit mikrofinanciar në Shqipëri" 30 Qershor, 2022

Tryeza e Rrumbullakët e Investitorëve u organizua nga Mikrofinanca Shqiptare në Wyndham Grand Stamboll në Konferencën e 24-të Vjetore të Qendrës së Mikrofinancës ku mbledhi investitorët nga **Banca Etica, Foundation Grameen Credit Agricole, Enabling Capital AG** me një interes

të madh për tregun financiar shqiptar dhe aktorët e tij, si dhe përfaqësues të IMF-ve, anëtarët e AMA-s në një diskutim shumë interesant rreth zhvillimit të sektorit, dinamikës, investimeve dhe potencialit të fortë të tij.



5.1.4 Përmbledhje e diskutimeve të Grupit të Punës IV, “Përfshirja financiare e refugjatëve dhe azilkërkuesve”

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në bashkëpunim me UNHCR Albania zhvilloi një seminar me temë: “Përfshirja financiare e refugjatëve dhe azilkërkuesve” 15 Dhjetor, 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, në bashkëpunim me UNHCR, Albania, organizuan në datën 15 dhjetor 2022 një seminar me temë: **Përfshirja financiare e refugjatëve dhe azilkërkuesve.**

Synimi i këtij seminari ishte vlerësimi i nevojave financiare të refugjatëve për të kuptuar përfshirjen e tyre, kërkesën dhe përdorimin e shërbimeve financiare në vend, dhe për të vlerësuar interesin nga ofruesit e shërbimeve financiare për të shtrirë produktet dhe shërbimet e tyre tek popullata refugjate.

Nga ana e Shoqatës në event u prezantuan mundësitë për sektorin financiar për t'u shërbyer refugjatëve dhe praktikat më të mira të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve financiare në vende të tjera. Ndërkohë që nga ana e UNHCR Albania pjesëmarrësit u njohën me situatën socio-ekonomike të refugjatëve, kuadrin ligjor dhe nevojat e jetesës, si edhe me praktikat aktuale ndërkombëtare në lidhje me përfshirjen efektive të refugjatëve duke e parë në dritën e një qasjeje pjesëmarrëse për praktikuesit në nivel lokal. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe UNHCR Albania do të vijojnë këtë bashkëpunim edhe gjatë vitit 2023,



5.2 DITA EUROPIANE E MIKROFINANCËS 2022

5.2.1 Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mban eventin vjetor me temë: “Ecim përpara në kohë ndryshimesh, zëri i mikrondërmarrjeve”

Dita Europiane e Mikrofinancës - 20 Tetor, 2022



Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, në bashkëpunim me Rrjetin European të Mikrofinancës dhe Qendrën për Mikrofinancën, organizuan në datën 20 tetor 2022, një event celebrues në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Mikrofinancës, një fushatë vjetore e cila mbahet për të katërtën herë radhazi në Shqipëri.

Tema e këtij eventit ishte **“Ecim përpara në kohë ndryshimesh, zëri i mikrondërmarrjeve”**.

Zëri i mikrondërmarrjeve dhe roli i tyre në ekonominë e vendit është vendimtar! Ato janë mundësia e sipërmarrësit për të ndërtuar jetën e vet në Shqipëri, për të progresuar nëpërmjet iniciativës së lirë, dhe





organizata si motra të shoqërisë civile, përfaqësues të sektorit bankar, partnerë dhe dashamirës të sektorit të mikrofinancës, përfaqësues të mediave, etj.

Eventi u përshëndet nga z. Eduard Shalsi, Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, z. Enio Civici, zv. Ministër për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, z. Deniz Dërralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë dhe znj. Caroline Tsilikounas, Drejtore e Përgjithshme e Rrjetit European të Mikrofinancës.

për të krijuar një ambient produktiv dhe mbështetës për konsumatorin shqiptar! Mikrofinanca i ka mbështetur dhe i mbështet sipërmarrësit në rrugën e tyre të vështirë dhe sfiduese, duke u bërë partnere jo vetëm në financat e tyre, por në gjithë rrugëtimin e tyre drejt zhvillimit!

Të pranishëm në event ishin përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Banka Botërore, KFW,

Prezantime interesante dhe informative në këtë event sollën gjithashtu znj. Herjola Spahiu, Drejtore Ekzekutive e NOA sh.a. dhe anëtare e Bordit Drejtues të Rrjetit European të Mikrofinancës, z. Fatos Cocoli, ekspert për ekonominë dhe gazetar ekonomik, zj. Anja Deinzer, Drejtore e Zyrës German Sparkassestiftung në Shqipëri, si edhe znj. Elvana Sharkaj, Administratore e UniFin SHKK. Eventu kaloi në një atmosferë të ngrohtë dhe ofroi mundësi rrjetëzimi për të ftuarit dhe partnerët.



5.3. KONFERENCA E 24-VJETORIT TE MFC, QENDRA PER MIKROFINANCEN E ORGANIZUAR NE STAMBOLL

5.3.1 Konferenca Vjetore e organizuar nga Qendra për Mikrofinancën (MFC), me temë: "Investimi i Mikrofinancës në Kohë të Pasigurta" - 29-30 Qershor, 2022.



Konferenca e 24-të Vjetore e MFC-së, eventu më i madh për sektorin e mikrofinancës u zhvillua në Stamboll, në datat 29-30 Qershor 2022. Kjo ngjarje e jashtëzakonshme u zhvillua për të eksploruar dhe kuptuar më qartë peisazhin dhe mundësitë e investimeve mikrofinanciare, përditësime të rëndësishme të sektorit dhe qasjet më të fundit për çështjet gjinore, financat e gjelbra, teknologjië, sfidat dhe përfshirja financiare e refugjatëve dhe emigrantëve.

Konferenca priti më shumë se 400 liderë të mikrofinancës, politikëbërës, ekspertë, investitorë, ofruesit e IT-së, donatorët, nga 40 vende, me pjesëmarrjen më të madhe nga Bosnja dhe Hercegovina, Kazakistani dhe Gjeorgjia.

Konferenca, me më shumë se 30 folës në fjalimin kryesor, 4 seanca plenare, 9 tryeza diskutimesh teknike ishte ngjarja më e madhe e vitit në sektorin mikrofinanciar.

Ishte një mundësi e shkëlqyer rrjetëzimi për profesionistë nga e gjithë bota. U rivendosën lidhje, u bënë marrëveshje dhe u forcuan partneritetet ekzistuese. Institucionet që ofrojnë zgjidhjet dixhitale u dhanë delegatëve përvojë praktike me shërbimet e tyre dhe krijuan një hapësirë për të diskutuar mbi partneritetet efektive në të ardhmen.

Konferenca korri goxha sukses në planin impaktues dhe investues mbi institucionet dhe vendet pjesëmarrës

5.4 DREJTIMI I KESHILLIT MBIKEQYRES SE MFC

5.4.1 Emërimi i Sekretares së Përgjithshme të AMA-s si Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës të MFC

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare njofton me kënaqësi emërimin e Sekretares së Përgjithshme të saj, **Znj. Brunilda Isaj**, si **Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës** të Microfinance Centre (MFC).


Microfinance Centre është një rrjet i financës sociale që promovon drejtësinë, gjithëpërfshirjen, barazinë dhe përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve financiare. Rrjeti bashkon rreth 100 organizata nga 36 shtete të Europës dhe Azisë Qëndrore, të cilat së bashku ofrojnë produkte dhe shërbime mikrofinanciare për rreth 2 milion klientë më të ardhura të ulëta.

Brunilda Isaj ka një karrierë të suksesshme në sektorin bankar dhe financiar shqiptar, dhe tashmë edhe në nivel ndërkombëtar. Ajo kontribuon me përvojën e saj si advokuese dhe promovuese e sektorit mikrofinanciar, duke marrë pjesë aktive në politikëbërje dhe në fushën rregullatore. Brunilda është organizatore dhe drejtuese e një sërë tryezash të rrumbullakëta diskutimesh dhe eventesh për adresimin e sfidave të mikrofinancës dhe arritjen e zgjidhjeve tona për to, në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, rregullatorët, investitorët dhe palët e interesuara, me synimin për të mbështetur sektorin dhe shtresat vulnerabël të shoqërisë të cilët kanë pak ose aspak akses në sistemin bankar.



5.5 "SOCIAL FINANCE VIBE 2022"

4.5.1 KONFERENCA VIRTUALE E MFC ME TEME: "Drejt një të ardhmeje elastike" 9-10 NENTOR, 2022



"Social Finance Vibe 2022" ishte edicioni i dytë i konferencës virtuale të organizuar nga MFC me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe partnerëve të tjerë.

Eventi më i madh virtual i mikrofinancës mirëpriti rreth 600 pjesëmarrës, ku folësit kryesorë ishin profesionistë të sektorit mikrofinanciar dhe sipërmarrjeve sociale dhe mbi 50 profesionistë ekspertë për të ndarë dhe shkëmbyer njohuritë e tyre.

Gjatë 2 ditëve të zhvillimit të konferencës përdorimi i teknologjisë së lartë për mbajtjen e sesioneve virtuale, asistencë teknike e pandërprerë dhe efektive, ndërveprimi me anë të lidhjeve elektronike mundësoi suksesin e konferencës.

Theksi u vendos tek eksplorimi i mundësive për zhvillim e ekonomisë sociale, rolin e ofruesve financiarë në ekosistemin e ekonomisë sociale dhe mega trendet e tranzicionit të gjelbër dhe digjital, edhe ndikimi i luftës në Ukrainë. Debate kryesore u zhvilluan mbi tendencat kryesore dhe çështjet e nxehta me të cilat përballet zhvillimi i fundit i financave sociale, mbi Plani Veprimin e BE-së për Ekonominë Sociale të nisur rishtazi.

"Talk with Leaders" ishte sesioni që paraqiti përvoja praktike të liderëve, ekspertëve që punojnë në institucione të veçanta të ekonomisë sociale.

SFV 2022 është konferenca tërësisht miqësore me natyrën, zhvillimi i konferencës virtuale ndihmon planetin duke reduktuar mbetjet, bashkon njerëz në audiencë më të gjerë dhe e gjitha kjo na çon drejt një të ardhme elastike .

6 FINANCAT DIXHIITALE

6.1 FINTECH CONFERENCE 2022

6.1.1 FINTECH DAYS TIRANA - 23 SHTATOR, 2022



“Fintech Days Tirana- Kur teknologjia bashkohet me Financën – Transformimi Dixhital” ishte një ngjarje unike, e cila konsistonte në një konferencë njëditore dhe një Hackathon treditur.

“Fintech Days Tirana” bashkoi një komunitet më të gjerë të financave dixhitale: ofruesit e zgjidhjeve, përdoruesit përfundimtarë, bizneset tradicionale, bankat, këshilltarët, akademikët, studiuesit dhe përfaqësuesit e qeverisë nga Shqipëria dhe rajoni, në mënyrë që të krijonte një vend unik takimi që do të mundësojë pjesëmarrësit të takohen dhe të shkëmbejnë njohuri.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ishte pjesë e kësaj konference unike, e cila bëri bashkë mbi 200 pjesëmarrës, me 25 folës, 4 sesione plenare dhe 20 tema të trajtuara.

Në sesionin e dytë me temë: “Kohë Transformimesh për Mikrofinancën” u zgjerua fokusi për sektorin e mikrofinancës me përfaqësuesit lider të tij në treg.

Nën moderimin e Sekretares së Përgjithshme të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare Znj. Brunilda Isaj, me të ftuar të nderuar- CEO e Kredo Finance, Znj. Arlinda Muja, CEO e NOA Albania, Znj. Herjola Spahiu, CEO e CARDO AI Z. Altin Kadareja dhe COO të EASY PAY Z. Endri Kote.

Në këtë panel u trajtuan çështje:

- Si mund t'i përdorim pagesat dixhitale për të përmirësuar dhe rinovuar peizazhin e mikrohuadhënies në Shqipëri?
- Si po revolucionarizojnë kompanitë Fintech dhe mikrohuadhëniet se si të shfrytëzojnë të dhënat për të rritur hyrjen në bord, për të vlerësuar dhe parashikuar rrezikun e kredisë, për të parandaluar delikuentat dhe për të përmirësuar përvojën e klientit gjatë gjithë ciklit jetësor të huadhënies?

Industria e shërbimeve financiare është në përshtatje të vazhdueshme me ndryshimet teknologjike. Një ekosistem në ndryshim i huadhënies po i shtyn huadhënësit të përdorin të dhëna për të mbajtur ritmin me inovacionin në rritje të sektorit.



6.2 ALLWEB ALBANIA 2022

6.2.1 KONFERENCA NDERKOMBETARE E MARKETINGUT DIXHITAL, 2 NENTOR 2022



Më 2 Nëntor u rikthye Konferenca më e madhe dixhitale në Shqipëri.

Pas 2 viteve mungesë, Allweb erdhi me misionin **“Të ofrojë përmbajtje cilësore, folës të shkëlqyer, raste studimore praktike, shkëmbim njohurish dhe shumë më tepër.”**

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ishte partnere e këtij eventi të rëndësishëm, i cili paraqiti vlerë të shtuar jo vetëm për institucionet anëtare, por për të gjithë ekosistemin e sipërmarrësve në vend.

Me pjesëmarrjen e 12 folësve ndërkombëtarë, rajonalë dhe vendas, nën drejtimin e Gerti Boshnjakut, themelues dhe drejtues ekzekutiv i New Media Group, themelues i Business Magazine Albania dhe drejtues i portalit AlbaniaTech.

Temat e trajtuara kishin në fokus marketingun dixhital, kreativitetin, metaverse, përvojën e përdoruesit, web3 dhe strategjive të biznesit, dhe si çdo herë praktikën më të mirë të marketingut dixhital.

6.3 TIRANA FINTECH HIVE 2022

6.3.1 KONFERENCA “TIRANA FINTECH HIVE 2022”, 16-17 NENTOR 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë si partner mbështetës në Konferencën e organizuar nga Elmangos Ventures **“Tirana Fintech Hive 2022”**. Kjo konferencë e organizuar nga Elmangos Ventures, ishte një vlerë e shtuar për zhvillimin e mëtejshëm të financave dixhitale në Shqipëri, në rajon e më tej.

Ky event bëri bashkë aktorë të rëndësishëm të tregut financiar shqiptar dhe ndërkombëtar, që ndanë opinionet, eksperiencat dhe prishmëritë e tyre në lidhje me zhvillimin e teknologjisë financiare në Shqipëri.

Në panelin e dedikuar për mikrofinancën **“Rinovimi i Mikrofinancës përmes Fintech”**, morën pjesë drejtuesit ekzekutivë të dy prej anëtarëve tanë, Znj Arlinda Muja e Kreda Finance dhe Z.Akan Ajdini i LuteCredit Albania, të cilët ndanë me të ftuarit eksperiencat e tyre drejt ndërtimit të procesit të kredidhënies tërësisht online.

Konferenca u ndoq me interes nga një audiencë e gjerë drejtuesish të institucioneve financiare, pedagogë e studentë si edhe segmente të tjera interes.



6.4 FUSHATA HUAMARRJE E ZGJUAR 2022

6.4.1 FUSHATA "HUAMARRJE E ZGJUAR"

Fushata "Huamarrje e Zgjuar" promovon standardet globale të mbrojtjes së klientit. Kjo fushatë vjetore ndërkombëtare drejtohet nga Microfinance Centre (MFC) dhe partnerët e saj.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare është një anëtare krenare e këtij rrjeti mahnitës me kontribute të vlefshme që përpiqet për drejtësi, mundësi të barabarta dhe etikë në ofrimin e shërbimeve financiare.

Me kënaqësi pranuar Çmimin si Anëtarë të Angazhuar nga Microfinance Centre (MFC) për pjesëmarrje aktive dhe promovim të standarteve globale të mbrojtjes së konsumatorit, nëpërmjet fushatës **BorrowWisely - Huamarrje e Zgjuar**, ofruar Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, por edhe Agro & Social Fund, Fondi Besa dhe NOA!

Krenarë për anëtarët tanë dhe standartet që ata përcjellin në veprimtarinë e tyre!



7

KËRKIME DHE PUBLIKIME

7.1 SONDAZHI NE LIDHJE ME IMPAKTIN SOCIAL TE MIKROFINANCES NE JETEN E VENDIT

SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE PUBLIKON INDIKATORET FINANCIARE PER VITIN 2021 DHE REZULTATET E SONDAZHIT MBI IMPAKTIN SOCIAL TE VEPRIMTARISE NE REALITETIN SHQIPTAR , 13 MAJ 2022.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mbajti në datën **13 maj 2022** një takim me gazetarë të ekonomisë dhe përfaqësues të media në vend, për të përcjellë informacion në lidhje me veprimtarinë e sektorit gjatë vitit 2021, si edhe rezultatet e një sondazhi në lidhje me ndikimin social të mikrofinancës në jetën e vendit.

a) Veprimtaria e sektorit të huadhënies jo-bankare dhe mikrokredisë

Veprimtaria mikrofinanciare gjatë vitit 2021 me konsiderua me progres të kënaqshëm, indikatorë financiarë të qëndrueshëm dhe një administrim të mirë të burimeve në dispozicion. Anëtarët e Shoqatës në mënyrë të integruar kanë një total bilanci prej rreth 47 miliardë lek dhe një portofol kredie prej rreth 35 miliardë lek, me një rritje prej 12% dhe 14% përkatësisht. Kredia e re e vendosur në dispozicion të individëve, biznesit të vogël dhe fermerëve u zgjerua me 91% në vëllim dhe me 48% në numër kredish krahasuar me vitin 2020, i cili ishte një vit pandemie. Në vëllimin e kredisë së re individët zunë peshën prej 52%, mikrobizneset 37% dhe fermerët 10%. Fakt i rëndësishëm është se 85% e financimit të akorduar për bujqësinë gjatë vitit 2021 pati si burim mikrofinancën.

Sektorit paraqiti indikatorë të qëndrueshëm



financiarë, me kthim në aktivet e veta prej 3% dhe kthim në kapital prej 17%, ndërkohë që kreditë me probleme (NPL) raportohen në nivelin e 6.5% e portofolit. Pavarësisht këtyre indikatorëve, sektori është i ndërgjegjshëm për rreziqet e shtuara që kanë filluar të shfaqen gjatë vitit 2022, ku zhvillimet më të rëndësishme i atribuon rritjes së normës së inflacionit dhe tendencës rritëse në normat bazë të interesit.

b) Studimi Përfshirja dhe Ndikimi Social i Institucioneve të Mikrofinancës në Shqipëri

Studimi i zhvilluar gjatë muajve Dhjetor 2021 - Mars 2022 nëpërmjet pyetësorve të shpërndarë përmes platformave digjitale tek anëtarët e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, ku janë mbledhur opinionet e 8 prej anëtarëve të Shoqatës. Ky pyetësor shërben për të pasqyruar përpjekjet e institucioneve të mikrofinancës për të qenë të përfshirë në jetën e klientëve dhe komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Disa nga **përfundimet e nxjerra** nga ky raport sugjerojnë se:

1- Institucionet anëtarë të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare janë në përpjekje të vazhdueshme që të krijojnë produkte të reja dhe të përmirësojnë proceset dhe shërbimet e tyre ndaj klientëve në mënyrë që të krijojnë gjithnjë e më shumë mundësi

qasjeje në financim për të gjithë ata të cilën nuk e kanë këtë mundësi.

2- Mikrofinanca në Shqipëri përveç përfshirjes financiare ka si premtim kryesor të saj in edukimin financiar për të gjithë klientët e saj si dhe më tej.

3- Institucionet e Mikrofinancës bëjnë përpjekje të vazhdueshme nëpërmjet angazhimit të stafit si dhe buxhetimit të tyre që të ndihmojnë grupe të veçanta të marginalizuara, nëpërmjet projekteve individuale dhe jo në mënyrë të organizuar.

4- Të gjithë klientët përveç informimit të saktë dhe të detajuar mbi kredinë që ata marrin kanë dhe një sërë instrumentesh në dispozicion të cilat ndihmojnë klientin që të kërkojë ndihmë, të shprehë pakënaqësitë apo të marrë më tepër informacion.

5- Mbështetja ndaj grave në sipërmarrje shprehet nëpërmjet përfshirjes së saj në nivelet më të larta drejtuese por edhe në raportin e klienteve gra kundrejt totalit të klientëve të financuar.



LOBIMI DHE ADVOKIMI

8.1 MARREDHENIET ME QEVERINE, AGJENSITË DHE KOMISIONE QEVERITARE

Për misionin e saj strategjik dhe objektivat kryesore, sigurisht që Shoqata konsideron si partner kyç dhe të një rëndësie parësore ndërveprimin dhe bashkëpunimin me organet qeveritare në nivel kombëtar dhe lokal, së bashku me agjensitë dhe komisionet e ngritura nga shteti për biznesin dhe ekonominë. Interesi i saj shtrihet jo vetëm në përfaqësimin e anëtarëve tek këto organe, por edhe për përditësimin dhe njoftime në mënyrë të anasjelltë lidhur me kuadrin ligjor e rregullator, ndryshimet dhe reformat, politikëbërje, udhëzimeve si edhe dispozitave në fuqi për ushtrimin e biznesit

dhe operimin në treg me përgjegjësi ekonomike e sociale. Ajo luan jo vetëm një rol aktiv, por kur është e nevojshme edhe proaktiv në funksion të praktikave më të mira të biznesit, përmirësimit të kushteve për gjithë procesin e kredidhënies dhe përmbushjes së misionit social, duke marrë pjesë në konferenca e seminare, seanca dëgjimore, e gjithashtu në forume të përbashkëta për qëllime të ndryshme. Shoqata e quan një detyrë të rëndësishme dhënien e informacionit dhe prezantimin e aktivitetit dhe progresit të anëtarëve të saj në mënyrë frekvente gjatë periudhave kohore të raportimit.

Përsa i përket nivelit ministror shoqata bashkëpunon me këto organe;

- Ministrinë e Financave dhe e Ekonomisë
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Lidhur me bashkëpunimin me qeverinë lokale, shoqata ndërvepron dhe kooperon me njësitë vendore ose përfaqësueset e tyre për projekte në zona dhe komuna si në ato urbane ashtu edhe rurale, për të nxitur dhe shpërndarë informacion lidhur me fushata ndërgjegjësimi, sesione trajnimi apo edukimi.

Po kështu, mjaft aktive është shoqata edhe në veprimtarinë e saj me agjensitë qeveritare të ndryshme, komisione e këshilla të cilat kanë për qëllim të udhëzojnë dhe këshillojnë për zhvillimin e elementëve të biznesit të sektorit të mikrofinancës në tërësi dhe në veçanti.

8.1.1 KESHILLI I INVESTIMEVE - PRIORITETET E INVESTIMEVE PËR VITIN 2022 - 31 JANAR, 2022

Mbledhje e posaçme e Këshillit të Investimeve kryesuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Znj. Delina Ibrahimaj për të diskutuar:

-Shtyllat e ndërhyrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend në vijim të rekomandimeve të Këshillit të Investimeve dhe përfaqësuesve të biznesit

-Si mund të përfshihen shoqatat e bizneset në grupet e reja të punës për të ndihmuar në mënyrë proaktive me ekspertizën e tyre sipas fushave përkatëse të ndërhyrjes?

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ishte pjesëmarrëse në mbledhjen "ad hoc" të thirrur nga Kryetarja e Këshillit të Investimeve, Znj. Delina Ibrahimaj, ku u diskutuan mundësitë e përmirësimit të klimës së investimeve në vend, duke u bazuar në një gamë të gjerë rekomandimesh të paraqitura nga komuniteti

8.1.2 SHOQATA MIKROFINANCA SHQIPTARE REALIZON SEANCEN DEGJIMORE ME KOMISIONIN E EKONOMISE DHE FINANCIVE NE KUVENDIN E SHQIPERISE, 14 QERSHOR 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare raportoi në një seancë dëgjimore me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë, e cila u zhvillua me kërkesë të Shoqatës në datën 14 qershor 2022. Qëllimi i raportimit në Komision ishte ofrimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar për veprimtarinë mikrofinanciare në Shqipëri, arritjet dhe sfidat e saj, impaktin e saj social dhe ekonomik në vend, si edhe pritshmëritë për forcimin e partneritetit midis sektorit dhe organeve qeverisëse të vendit.

Prioritete të kësaj seance ishin prezantim i veprimtarisë financiare të institucioneve financiare jo-banka, me fokus tek kredia dhe mikrokredia; ecuria e veprimtarisë, zhvillimi i mikrofinancës ndër vite, tendencat kryesore; natyra e produkteve dhe shërbimeve financiare, normat e interesit nominale dhe efektive dhe kompozimi i tyre, veprimtaria e mbledhjes së kredive në vonesë; çështje të transparencës dhe etikës në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare jo-bankare, çështje të edukimit financiar; sfidat e sektorit për të ofruar shërbime të digjitalizuara në tërësinë e tyre;

Ndër kërkesat kryesore të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare përmenden si më poshtë:

1- Sektorit t'i jepet akses në fonde më të lira, përfshi financimet nga institucionet financiare lokale apo edhe mundësia për të mbledhur mini-depozita nga tregu:

i biznesit, organizma ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë përqafësues në vend.

Sektori i mikrofinancës mbështeti nismat e ndërmarra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe shprehu gatishmërinë për të qënë një faktor kontribues në këto nisma, në mbështetje të mëse 200 mijë klientëve të tij, biznese e mikrondërmarrje, fermerë dhe qytetarë shqiptarë.

problematikat e sektorit dhe masat që janë marrë dhe po merren për zgjidhjen e tyre.

Një pjesë e mirë e diskutimeve u fokusuan në procesin e automatizuar të vlerësimit të aplikimeve për kredi të vogla të shpejta, për normat e interesit efektive të ofruara nga institucionet anëtare, për nivelin e kredive në vonesë dhe numrin e huamarrësve të cilët nuk ripaguajnë detyrimet në kohë dhe trajtimin e tyre më pas nga shoqëritë e blerjes së borxhit dhe organet përmbarimore, si edhe në nivelin e rrezikut të kredisë të marrë përsipër nga institucionet financiare jo-banka dhe mënyrën e zbutjes së tij. Përfaqësuesit e Shoqatës dhanë shpjegime të hollësishme dhe argumenta të plota në lidhje me shqetësimet e deputetëve, të cilat hodhën dritë mbi kompozimin e kostove të këtyre institucioneve të cilat përkthehen në kostot e kredive të ofruara, si edhe propozuan mënyra dhe mundësi për të ulur kostot e kredidhënies, nëpërmjet rritjes së partneritetit me organet ligjvënëse dhe ligjzbatuese, si edhe organet ekzekutive të qeverisjes.

2-Institucionet e mikrofinancës të përfshihen si pjesë me të drejta të barabarta në skemat e mbështetjes për biznesin dhe fermerët, të hartuara apo në proces hartimi nga Qeveria Shqiptare

3- Sistemit financiar në tërësi t'i ofrohet akses i rregulluar me ligj mbi të dhënat financiare të qytetarëve dhe bizneseve në platformën e-albania (me kërkesë dhe autorizim të plotë të klientit), për të automatizuar edhe më tej procesin e vlerësimit të aplikimeve të kredisë, kapacitetit pagues të klientëve dhe për t'i dhënë një shtysë dixhitalizimit të plotë të ofrimit të shërbimeve financiare

4- Qeveria të punojë për përmirësimin e sistemit dhe referimit të librit të adresave për të mundësuar një komunikim efektiv dhe në kohë të institucioneve mikrofinanciare me klientët e sektorit

5- Qeveria të mbështesë biznesin familjar dhe mikrondërmarrjet me politika të qënësishme, subvencione dhe ndërmjetësim në zinxhirin e vlerës, me qëllim uljen e rrezikut të goditjes së këtyre sektorëve nga kriza e çmimeve dhe pasojat e situatës konfliktuale në Ukrainë.

Seanca u zhvillua me një frymë konstruktive dhe pasqyroi rëndësinë e sektorit të mikrofinancës për organet ligjvënëse, në të mirë të zhvillimit ekonomik-social të vendit, mirëqënies së qytetarëve dhe mundësisë së rritjes së përfshirjes financiare të tyre.



8.2. MARREDHENIET ME BANKEN E SHQIPERISE

Duke iu referuar pjesës së tretë të këtij raporti, më lart përmendëm që institucionet financiare jo-banka dhe Shoqëritë e Kursim-Kreditit janë subjekte financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, e përberë nga këto institucione, ndër qëllimet e saj më kryesore, ka mbajtjen e raporteve të ngushta dhe bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë në disa aspekte. Kjo lidhet me përfaqësimin e anëtarëve të shoqatës, prezantimin e tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, ndihmesën në përmirësimin dhe interpretimin e ndryshimeve të aplikuara në planin rregullator financiar e operacional, e gjithashtu edhe shkëmbimit të informacionit cilësor dhe sasior gjatë fazave të zhvillimit të këtij sektori. Me reagimet dhe përgjigjet e saj, shoqata vëren dhe raportin tendencat apo prirjet e aspekteve financiare dhe sociale të sektorit brenda tij, sikundër edhe në plan të përgjithshëm në raport me ambientin ekonomik të vendit. Ajo gjithashtu shpreh qartë interesat e tyre duke u bazuar në fakte dhe analiza konkrete të

tregut dhe veçorive të anëtarëve.

Në këtë linjë, edhe gjatë vitit të kaluar janë mbajtur kontakte të vazhdueshme nga shoqata me Bankën e Shqipërisë për të takon ndryshimeve dhe përditësimeve rregullatore në procesin e hartimit dhe amendimit të ligjeve për Mikrofinancën.

Në shkëmbimet e informacionit dhe përvojës me homologët dhe organizata të tjera ndërkombëtare, shoqata informon me kënaqësi dhe krenari se një nga pikat më të forta të anëtarëve, si në nivel individual ashtu edhe në grup është raportimi frekuent dhe mjaft efikas me organet rregullatore dhe palët e treta me të dhëna të detajuara e kategorizime specifike dhe transparente. Për shumicën e të dhënave me palët e treta si në vend ashtu dhe me ato ndërkombëtare, anëtarët e shoqatës raportojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare financiare të raportimit (versioni 9)

8.2.1 Ndryshime të rëndësishme rregullatore

Gjatë vitit 2022, Banka e Shqipërisë njoftoi zyrtarisht për disa ndryshime rregullatore në drejtim të përcaktimit të një tavanit në normat efektive të interesit për kategorinë e kredive konsumatore dhe disa udhëzime të posaçme në mënyrën e përlogaritjes së koeficientit të mjaftueshmërisë së kapitalit për disa institucione mikrofinanciare.

Portugalisë, Francës dhe Belgjikës) për përcaktimin e a) (NEI) ashtu edhe për b) komisionet dhe penalitetet përkatëse duke u bazuar në llogaritjen e një mesatareje të tregut për këta tregues në lidhje me nivelin e normave të interesit, të komisioneve dhe penaliteteve të aplikuara, sidomos nga subjektet financiare jobanka për produktet e kredisë.

-Specifikisht për shifrat maksimum të Normës Efektive të Interstiti (NEI) si një tregues gjithëpërfshirës i kostove të njohura të kredisë, udhëzimet u dërguan nga Banka e Shqipërisë në mënyrë normative ku përcaktohej vendosja e tavanit të kredisë konsumatore, për 6-mujorin e dytë të vitit 2022, dhe u paraqitën në një matricë të ashtuquajtur "Formulari i Transparencës" me shifra "tavan" për produktet "Kredi me Kestë", "Overdraft", "Kartë Krediti", për fashat nga 0-200,000 Lekë dhe 200,000-2mil lekë. Ndryshimet synuan të përfaqësonin tregun tonë me praktikën më të mira evropiane (modelet e Bankës së

Eshtë e kuptueshme që deri në një farë shkalle, kjo preku drejtpërdrejt politikën e interesave dhe rrjedhimisht përfitueshmërinë e institucioneve. Në diskutimet dhe konsultimet e zhvilluara në lidhje me këto ndryshime, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare luajti një rol aktiv dhe reagoi nëpërmjet një komunikimi apo letrë zyrtare të dërguar në formën e përgjigjeve shpjeguese, kërkesave dhe sugjerimeve më në hollësi nga Sekretarja e Përgjithshme Znj. Isaj drejtuar Guvernatorit Z. Sejko dhe Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes, Z. Deralla.

Përmbajtja e kësaj letrë me objekt **"Në lidhje me zbatimin e përcaktimeve rregullatore të lidhura me tavanin në normat efektive të interesit për kreditë konsumatore"**, shkurtimisht mund të përmbledhet si vijon:

Duke paraqitur analiza konkrete dhe kushte të arsyeshme për institucionet anëtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas specifikave dhe modelit të biznesit të adoptuar prej tyre, u renditën disa argumenta: në drejtim të Kostos së Fondeve, Kostot e Administrimit të Rrezikut të Kredisë dhe Kostot Operacionale për Njësi Kredie. Pas shtjellitimit të këtyre faktorëve, në po këtë letër shoqata argumenton kërkesën e saj ndaj autoritetit mbikëqyrës për rishikim të rregullores dhe ndarjen e insitucioneve financiare jo-banka nga bankat e nivelit të dytë, në trajtimin e vendosjes së normës efektive maksimale për kreditë

konsumatore. Ajo gjithashtu ritheksoi sugjerimin e bërë më edhe parë që fashat duhen ndarë më tej, edhe në bazë të perkufizimit të mikrokredisë (0-200,001-600,000 lekë dhe 600,001-2,000,000 lekë)

Këto kërkesa e sugjerime u morën parasysht pjesërisht nga rregullatori.

Shoqata do të vijojë në mënyrë të vazhdueshme komunikimin dhe bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë në drejtim të ndërveprimit, vënies në dijeni për udhëzime dhe njoftime për rregulla të cilat me ndryshimet e tyre synojnë të përmirësojnë praktikën e biznesit dhe si qëllim fundor kanë mbrojtjen e konsumatorit nga çmime produktesh pa tavan dhe për të mos lejuar mundësinë e shfrytëzimit të praktikave ekstreme në treg.

8.2.3 MBLEDHJA E VIII E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE, 9 NËNTOR 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në mbledhjen e VIII të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, e cila u zhvillua në datën 9 nëntor 2022 nën drejtimin e Zv. Guvernatores së Parë dhe njëkohësisht Kryetare e këtij Komiteti, Znj. Luljeta Minxhozi.

Mbledhja e Komitetit u përshëndet dhe nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko dhe nga Ministre e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj.

Temat kryesore të diskutuara në këtë event patën fokus strategjinë kombëtare për edukimin financiar, zhvillimet në tregjet e pagesave në drejtim të kuadrit rregullator dhe operacional, si edhe tendencat novatore dhe risitë e sjella në treg nga kategoria fintech e institucioneve financiare banka dhe jo-banka.



8.2.4 Strategjia për Edukimin Financiar nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë Java Globale e Parasë, 21-27 Mars 2022

Java Globale e Parasë është një fushatë vjetore globale ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e sigurimit që të rinjtë, që në moshë të hershme, të jenë financiarisht të vetëdijshëm dhe gradualisht të fitojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe sjelljet e nevojshme për të marrë vendime të shëndosha financiare dhe për të arritur përfundimisht. mirëqenia financiare dhe qëndrueshmëria financiare. Java Globale e

Parasë e 10-të u zhvillua në 21-27 Mars 2022.

Motoja ishte: **Ndërtoni të ardhmen tuaj, tregohuni të zgjuar ndaj parave!!!**

Tema tregonte rëndësinë e të menduarit për të ardhmen kur merren vendime financiare.



8.2.5 TRYEZE DISKUTIMI "FINANCIMI I BUJQESISE NE SHQIPERI", 15 QERSHOR 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në tryezën e diskutimit në lidhje me **financimin e bujqësisë në Shqipëri**, organizuar nga Banka Botërore dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut, ndërmjetësve financiarë dhe palëve të përfshira në këtë proces të rëndësishëm.

Dëshirojmë të falenderojmë të dy institucionet

organizuese për mundësinë që i dhanë sektorit të mikrofinancës të paraqesë arritjet e tij në drejtim të financimit të bujqësisë, si edhe konsiderimin e komenteve dhe sugjerimeve tona në drejtim të zhvillimit dhe ecurisë së financimit, duke përshtatur zgjidhjet financiare me natyrën e tregut bujqësor dhe zhvillimin e produktit primar, që është në fokus të veprimtarisë kredidhënëse të sektorit të mikrofinancës.



8.2.6 Konferenca Ndërkombëtare “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve” 19 Maj,2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare e organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) dhe Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO), me temë “Diversifikimi i sistemit financiar përmes reformave të tregut të kapitaleve”. Si përfaqësuese e sektorit të mikrofinancës dhe institucioneve të saj që janë gati të listojnë titujt e parë në bursën e titujve. Konferenca u hap nga fjalët përshëndetëse të z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Patrik Meier, Zëvendëshefi i Misionit të Ambasadës së Zvicrës në Tiranë, Z. Salinas, Përfaqësuesi

i Përhershëm i Zyrës së BB-së në Shqipëri, Z. Ahmetaj, Zëvendëskryeministër dhe Ministër Shteti për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.

Konferenca ishte e organizuar në tre panele kryesore, ku Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF ishte pjesë e panelit të parë me temë “Zhvillimi i Sektorit Financiar në Shqipëri: nga forcimi i stabilitetit financiar në mbështetjen e rritjes ekonomike”, të drejtuar nga z. Michael Edwards, Këshilltar i lartë për sektorin financiar pranë Bankës Botërore, me panelistë znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë dhe z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.



8.2.7 PERMIRËSIMI I KLIMES SE BIZNESIT NE SHQIPERI, 9 SHTATOR 2022

Me Kryeministrin Rama në një takim të zgjeruar me përfaqësues të dhomave dhe shoqatave shqiptare e të huaja u diskutua mbi përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e bashkëpunimit reciprok në funksion të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

Rekomandimet e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare për përmirësimin e klimës së biznesit ishin pjesë e një procesi të zgjeruar konsultativ, për të cilin

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nën kujdesin e Kryeministrit Edi Rama mbajti një takim përditësues.

Duke vlerësuar përfshirjen e këtyre rekomandimeve dhe ftesën për të marrë pjesë në këtë proces të rëndësishëm, shprehim gatishmërinë tonë për të kontribuar më tej në krijimin e një klime inkurajuese, të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për biznesin në këto kohë të vështira.



8.2.8 EVENTI: "BUJQESIA , TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NE ZONAT RURALE NE SHQIPERI "29 PRILL 2022

Shoqata pati kënaqësinë të marrë pjesë në eventin e organizuar nga **Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar** me temë "Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedi në Zonat Rurale në Shqipëri", me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara nga qeveria, arsimit, ekspertë të fushës, agjensi zbatuese

të projekteve për bujqësinë, dhe shoqatat e biznesit.

Sektori i mikrofinancës mbetet i përkushtuar në mbështetjen financiare që ofron për fermerët dhe agrobiznesin, dhe mirëpret interesin e politikëbërjes në mbështetje të këtij sektori kaq të rëndësishëm.



FINANCIMI I BUJQESISE NGA INSTITUCIONET E MIKROFINANCES


- Mikrofinanca ka disbursuar më shumë se 3.6 miliardë Lek kredi të reja për bujqësinë dhe fermerët shqiptarë, me përfitues rreth 8 mijë fermerë, ferma, kompani agropërpunimi dhe kompani agro-turizmi.
- Portofoli gjendje i kredisë për bujqësinë për fundin e vitit 2021 ishte 6.4 miliardë lekë, ose rreth 53.4 milion EURO, i shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe i fokusuar në të gjitha degët e bujqësisë.
- Fermeri shqiptar zotëron një fermë mesatare prej 1.2ha, e ndarë në katër parcela. Krahasimi me mesataren europiane prej 15ha dhe atë amerikane prej 150 ha, bën që ferma dhe bujqësia shqiptare t'i korrespondojë realitetit të një mikro-ekonomie familjare, me kosto të larta operimi dhe aksesimi në financë.
- Specializimi i mikrofinancës në financimin e bujqësisë në vend vjen si rezultat i një investimi konstant prej me shumë se 25 vitesh në trajnimin e stafëve, në zhvillimin e produkteve fleksibël sipas kalendareve të prodhimit bujqësor, në zhvillimin e teknologjive mobile rurale, në ofrimin e agro-asistencave profesionale ashtu si dhe të përfshirjes së fermerëve shqiptarë në skemat e garancive europiane.



RRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TE ANETAREVE DHE BASHKEPUNIMET NDERKOMBETARE

9.1. BASHKEPUNIME ME RRJETET NDERKOMBETARE

9.1.1 EVENTI "MIKROFINANCA E PACE – FEMINILE PLURALE" 18 JANAR 2022



"Microfinanca e Pace – Feminile Plurale" ishte një event online i organizuar nga Banca Etica, i fokusuar në ndikimin që mikrofinanca ka në arritjen e qëllimeve sociale në shoqëri, me fokus tek gratë si mundësuese kyçe të progresit dhe mirëqenies për vendet në të gjithë botën.

Ky forum 2 orësh ishte një shprehje dhe shkëmbim informacioni, idesh, propozimesh dhe mbi të gjitha ndjenjash që shoqërojnë misionin mikrofinanciar që nga gjeneza deri në ditët e sotme.

Një mbulim dhe fokus i rëndësishëm u siguroi për vendet e Ballkanit Perëndimor, si Shqipëria dhe Bosnje Hercegovina, të cilat padyshim janë një zonë me interes të madh për politikëbërësit, zhvillimin e institucioneve financiare dhe rrjetet në Evropë dhe Itali, për të përfaqësuar Shqipërinë në këto diskutime.

Brunilda Isaj, Sekretare e Përgjithshme e AMA, prezantoi disa indikatorë nga sektori dhe të dhëna për pozicionimin e grave në Shqipëri, dhe çfarë po bëjnë sektori i mikrofinancës në tërësi dhe Shoqata Shqiptare e Mikrofinancave për të adresuar sfidat

dhe nevojat e shtresat vulnerabël të shoqërisë shqiptare.

Në këtë aktivitet ishin ftuar si folës:

Francesca Benciolini, Këshilltare e Komunes së Padovës me përgjegjësi për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Paqen

Anna Fasano, Presidente e Banca Etica

Katarzyna Pawlak (MBA) Pawlak, CEO e Qendrës Mikrofinanciare

Caroline Tsilikounas, CEO e Rrjetit Evropian të Mikrofinancës

Elma Zukic, Presidente e Shoqatës së Institucioneve Mikrofinanciare në Bosnje dhe Hercegovinë

Marina Piccioni, Drejtuese e Partneritetit Multilateral dhe Financave, Cassa Depositi e Prestiti

Giulio Dal Magro, Drejtues i Financimit të Zhvillimit, Cassa Depositi e Prestiti

Veprimtaria u moderua në mënyrë të shkëlqyer nga Gabriele Giuglietti, Shef i Punëve Institucionale dhe Marredhenieve me Jashtë, Banca Etica.

9.1.2 EVENTI "PADOVA CHIAMA SARAJEVO: 30 ANNI INSIEME PER LA PACE", 5 PRILL 2022

Të martën, më 5 prill, në orën 9.00, Banca Etica dhe Komuna e Padovës, me bashkëpunimin e Qendrës Universitare për Të Drejtat e Njeriut "Antonio Papisca" dhe Observatori Transeuropa i Ballkanit dhe Kaukazit/Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, organizuan eventin "Padova takon Sarajevën: 30 vite së bashku për paqen, projektet dhe përvojat e bashkëpunimit për një të ardhme pa luftë".

Në këtë event morri pjesë edhe **Mikrofinanca Shqiptare** nëpërmjet Sekretares së Përgjithshme Znj. Brunilda Isaj, e cila në fjalën e saj u ndal në rëndësinë që sektori ka në krijimin e mundësive për shtresat e varfra të popullatës dhe ato që nuk kanë akses në sektorin bankar, si edhe në mbështetjen e sipërmarrjes dhe iniciativës private qoftë ajo në zonat urbane në formën e kompanive start-up, ashtu edhe në zonat rurale në sektorin e bujqësisë, agro-përpunimit dhe agro-turizmit.



Eventi u ndoq nga një numër i madh pjesëmarrësish, përfshirë edhe folës të shquar si:

Francesca Benciolini - Këshilltare për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Paqe, Komuna e Padovës

u BiH - Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Bosnjës dhe Hercegovinës,

Gabriella Salviulo - Drejtore e Qendrës Universitare për të Drejtat e Njeriut "Antonio Papisca",

Katarzyna Pawlak - CEO Microfinance Centre (MFC), Varshavë (Poloni)

Universiteti i Padovës, Elma Zukić - Presidente e AMFI BiH- Udrženje mikrokreditnih organizacija

Gabriele Giulietti, Drejtor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare te Banca Etica.



9.2 PROGRAM TRAJNIMI ME 4 SESIONE PER ADMINISTRIMIN E RREZIQEVE NGA INSTITUCIONET FINANCIARE JO-BANKA MBESHTETUR NGA DSIK ALBANIA

9.2.1 Tema: "Administrimi i Rreziqeve në Institucionet Financiare Jo-Banka"

Me datë 13-14 Tetor dhe 20-21 Tetor Mikrofinanca Shqiptare organizoi një seri trajnimesh online me temë "Administrimi i Rreziqeve në Institucionet financiare jo-Banka".

Pikat kryesore të trajnimit ishin:

1. Parimet e riskut dhe menaxhimi i riskut të kredisë
2. Analiza e Pasqyrave Financiare

German Sparkassenstiftung Albania ishin partnerë mbështetës të aktivitetit, ku trajnues ishte **z. Oleg Flaum**, i cili është një ekspert ndërkombëtar në fushën bankare dhe shërbimet financiare.

Sesione të tilla për rritje kapacitetesh do të organizohen në vijimësi nga Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, për të asistuar stafin e anëtarëve dhe për të rritur produktivitetin dhe performancën e tyre në funksionet që kryejnë.



9.3. GREEN FINANCE ONLINE WORKSHOP

9.3.1 Tema: "Financat e Gjelbra dhe Risku ESG", 7 Dhjetor 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në partneritet me German Sparkassenstiftung Albania dhe Shoqatën e Bankave organizuan një seminar online për drejtuesit të institucioneve të sektorit financiar në Shqipëri, me temën e Financave të Gjelbra.



Workshopi u mbajt më 7 dhjetor 2022 dhe u fokusua në çështjet kryesore si:

- Nga Ekonomia e Gjelbër te Financa e Gjelbër
- Koncepti dhe komponentët e Financës së Gjelbër
- Fokusi në rrezikun klimatik
- Zbatimi i praktikave më të mira/ shembuj projektësh

9.3.2 Tema: " Navigimi drejt Financave të Gjelbra; Radari I Riskut ESG dhe Busulla e Financave të Gjelbërta", 15 Dhjetor 2022

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në partneritet me German Sparkassenstiftung Albania dhe Shoqatën e Bankave organizuan seminarin e dytë online për drejtuesit të institucioneve të sektorit financiar në Shqipëri, me temën e Financave të Gjelbërta.



Workshopi u mbajt më 15 Dhjetor dhe u fokusua në çështjet kryesore si :

- Rruga drejt Financave të Gjelbra
- Risku klimatik ,social dhe i qeverisjes ,matja e tij dhe vlerësimi
- E Ardhmja - Financat e Gjelbra

9.4. DITA BOTERORE E KURSIMEVE

Dita Botërore e Kursimeve u vendos më 31 tetor 1924, gjatë Kongresit të 1-rë Ndërkombëtar të Bankës së Kursimeve (Shoqëria Botërore e Bankave të Kursimeve) në Milano, Itali. Në rezolutat e Kongresit të Kursimeve u vendos që 'Dita Botërore e Kursimeve' të jetë një ditë e përkushtuar ndaj promovimit të kursimeve në të gjithë botën. Në përpjekjet e tyre për të promovuar kursimet, bankat e kursimeve punuan gjithashtu me mbështetjen e shkollave, klerit, si dhe shoqatave kulturore, sportive, profesionale dhe të grave.

Përfaqësuesit e 29 vendeve donin të sillnin në vëmendje "mendimin e kursimit" për publikun mbarëbotëror dhe rëndësinë e tij për ekonominë dhe individin. Dita Botërore e Kursimeve zakonisht mbahet më 30 tetor, me përjashtim të vendeve ku kjo

ditë është festë publike, pasi ideja është që bankat të jenë të hapura, në mënyrë që njerëzit të mund të transferojnë kursimet e tyre në llogarinë e tyre.

Me rastin e kësaj dite të veçantë, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në bashkëpunim me German Sparkassenstiftung Albania organizuan një sesion trajnimi me përfaqësues të segmenteve të ndryshme të klientëve të mikrofinancës, anëtarë të stafit, si edhe përfaqësues nga komuniteti i refugjatëve dhe personave të zhvendosur, me bashkëpunimin e zyrës UNHCR, Albania. Pjesëmarrësit u përfshinë në një lojë praktike për menaxhimin e financave personale dhe krijimin e standartit të pëlqyeshëm të jetesës nëpërmjet marrjes së vendimeve të duhura financiare.



10 PREZENCA NE MEDIA DHE RAPORTET ME PUBLIKUN

10.1 NJOFTIM INFORMUES PER PUBLIKUN-25 SHKURT 2022

Mikrofinanca Shqiptare në datën 25 Shkurt 2022 paraqiti një njoftim informues për publikun dhe klientët e institucioneve tona anëtare si më poshtë:

1- Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe Anëtarët e saj i binden Kodit të Sjelljes dhe të Praktikave të Mira, miratuar me Vendim të posaçëm të Asamblesë së Anëtarëve, dhe në këtë kuadër nuk adoptojnë dhe as ndjekin praktika të paligjshme apo jo-etike në veprimtarinë e tyre.

2- Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe Anëtarët e saj distancohen me forcë nga Shoqëritë e Mbledhjes së Kredive, nëpërmjet praktikave jo-ligjore, jo-etike, korruptive. Institucionet e Mikrokredise mbajnë të njëjtën licensë veprimtarie, por duhet të kuptohet nga tregu që aktiviteti i tyre ndryshon dhe nuk është i njëjtë.

3- Kredihënia nga të gjithë Anëtarët kryhet në përputhje me kapacitetin ripagues dhe prirjen e çdo kredimarrësi për të zbatuar detyrimet kontraktuale. E thënë kjo, ne marrim të gjitha masat të informojmë, dhe inkurajojmë të gjithë klientët tanë të informohen me detaje në lidhje me këto detyrime, si edhe me kushtet dhe termat e çdo kredie, përpara se të pranojnë detyrimin dhe ta marrin atë përsipër.

4- Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe Anëtarët e saj janë të vendosur të intensifikojnë përpjekjet e tyre në drejtim të edukimit financiar, përfshirjes financiare, ndihmës të shtresave në nevojë, eliminimin e hendekut gjinor në sipërmarrje dhe krijimit të vendeve të punës nëpërmjet sipërmarrjes, dhe do vijojnë të mbështesin ekonominë shqiptare nëpërmjet standardeve më të larta të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Në këtë kuadër, mirëpresim bashkëpunimin me çdo aktor të tregut që përfaqëson dhe mbron interesat e konsumatorëve për të koordinuar këto përpjekje në të mirë të konsumatorit shqiptar.

Në të njëjtën kohë, u shpreh gatishmëria si aktorë aktivë në tregun e kredidhënies dhe bashkëpunimi me autoritetet ligjvënëse dhe ligjzbatuese, ato qeveritare, rregullatore mbikëqyrëse, për hartimin e një kuadri ligjor dhe rregullator sa më të plotë, i cili do të përcaktojë qartësisht proceset dhe procedurat e mbledhjes së huave dhe do të identifikojë saktësisht të gjithë aktorët e përfshirë, sipas të drejtave dhe detyrimeve, për të shmangur abuzimin, zhvatjen dhe keqpërdorimin e situatës së vështirë financiare të qytetarëve, të cilat shkaktojnë probleme të thella ekonomiko-sociale në vend".

10.2 INTERVISTA DHE PARAQITJE TELEVIZIVE NE EMISIONE EKONOMIKE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka intensifikuar prezantimet në media gjatë vitit 2022 me anë të intervistave dhe pronocimeve të shumta për të folur për zhvillimet e sektorit, problematikat, normat e interesit, inflacionin dhe ekonominë në tërësi.

Shtohen kreditë, Shoqata e Mikrofinancës: E pritshme, por Shqipëria e ndjen 6 muaj më vonë efektin e krizave



Pas vitit post-pandemik, duket që në 2021 dhe këto muajt e parë të 2022 kërkesa për kredi shtuar edhe në vendin tonë.

Sipas Arlinda Mujës, kryetare e shoqatës së Mikrofinancës, është dyfishuar. Sipas saj, "ishte e pritshme që të ndodhte, duheshin rfinansuar bizneset dhe individët që kishin pësuar humbje në këtë periudhë".

Muja, e intervistuar në "Business News", shton se

pasojat e këtyre krizave vijnë në përgjithësi me vonesë. "Mendoj që në Shqipëri efektet e krizave globale ndodhin pak më vonë, zakonisht i ndejmë një 6-mujor më vonë. Sot shohim rritjen e inflacionit, kostoja për konsum është rritur. Kërkesa për kredi është sezonale".

Sipas saj, "kredia e individëve mban rreth 52% e totalit të disbursimeve, 30% e bizneseve dhe tjetra për sektorin bujqësor. Rritje në këtë sezon kemi për ata që merren me turizëm".

Rreziku për bizneset në krizë, Muja: Shqetësim për aftësinë paguese të kredive, impakti shihet në 6-mujorin e ardhshëm



Viti 2022 nuk ka qenë i lehtë për ekonominë dhe financat e qytetarëve, biznesit, por edhe shtetit. Sinjalet e rimëkëmbjes në periudhën post pandemisë u shuan shpejt nga lufta që nisi në Ukrainë në fund të shkurtit. Bota u përfshi sërish nga pasiguritë, që në ekonomi u reflektuan me një rritje të ndjeshme të çmimeve, karburanteve, energjisë elektrike. Inflacioni i lartë detyroi bankat qendrore në një pjesë të mirë të vendeve që të shtrëngonin politikën monetare, duke forcuar monedhat e tyre, në përpjekje për të frenuar inflacionin e lartë.

Sipas ekspertit për ekonominë Adrian Civici, "viti kishte shumë sfida. Viti paraardhës, 2021, dha shumë shpresa që rimëkëmbja do të sillte rritje.

Sektorë si turizmi dhe bujqësia ose shërbimet filluan trendin pozitiv dhe rikthimin e punësimit. Pra fundi i 2021 ekonomia mori kahun për t'iu rikthyer normaliteti. Por nga shkurti i 2022, për shkak të luftës në Ukrainë, u shfaq inflacion shumë i lartë, i shkaktuar edhe nga politikat relaksuese monetare të ndërmarra vitet e kaluara. Viti po mbyllet si me shumë goditje, ne shumë drejtime, ku më rëndë është pikërisht inflacioni, që ndikoi në uljen e fuqisë blerëse, por edhe çmimi i gazit dhe paqartësitë për garantimin e energjisë elektrike, veçanërisht atë të sipërmarrjeve. Por nëse rritja konfirmohet, 3.7% është pozitive për t'u vlerësuar, sepse kishim frikën e tendencave stagflacioniste.

10.3 REPORTAZH - REZULTATET IMPAKTUESE TE MIKROFINANCES - 31 GUSHT 2022

Alessandro Zoragniotti Drejtori politik i **NOTIZIEINUNCLICK** ka bërë një shkrim shumë mbresëlënës për sektorin e mikrofinancës në Shqipëri, një shembull i një sërë praktikash të mira që janë njohur si të denja për t'u marrë në konsideratë nga komuniteti ndërkombëtar i mikrokredisë. Gjithashtu ka vënë në pah rolin e mikrofinancës në edukimin financiar. Impakti në ekonomi i krijimit të vendeve të punës dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre.



10.4 EMISIONI ALERT-EDUKIMI FINANCIAR DHE KONSUMATORI -14 MAJ 2022

Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE), është një organizëm i krijuar në vitin 2018, i cili mbështetet nga dhjetë institucione financiare dhe organizata përfaqësuese të operatorëve të tregut: Shoqata Shqiptare e Bankave, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve, Shoqata e Tregtimit të Titujve, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE, Junior Achievement of Albania, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Shërbimi Kombëtar

Rinor dhe German Sparkassestiftung in Albania. Misioni kryesor i këtij rrjeti organizatash është që të kontribuojnë në përmirësimin e nivelit të edukimit financiar në vend, duke ndërgjegjësuar, advokuar dhe promovuar aktivitete të organizuara nga organizatat pjesëmarrëse për këtë qëllim.

Pikërisht për të folur mbi konsumatorin, praktikat informuese dhe më gjerë edukimin financiar ishin të ftuar në emisionin Alert të gazetarit Granit Sokolaj në News 24.



10.3 PODCAST- RENDESIA E MIKROFINANCES -20 MAJ 2022

Drejtoresha Ekzekutive e NOAs, Znj. Herjola Spahiu, foli në një intervistë për Finance Due Diligence Associates, përfaqësuar prej Z. Guy Rodwell, mbi praktikat më të mira të MFI dhe menaxhimin e marrëdhënieve me financuesit e tyre.

Në këtë podcast, Zj. Spahiu dha disa këshilla të vjera për të gjithë sektorin dhe rëndësinë e këtyre marrëdhënieve me partnerë financues, kundrejt të cilëve vlen të kushtohet një rëndësi e vecantë.



**Shoqata
Mikrofinanca
Shqiptare**



**Albanian
Microfinance
Association**